



Muaji i Ramazanit

MUAJI I DEVOTSHMËRISË



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

"Drita islame"
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

REDAKTORË
Andrin Rasha
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXX i botimit
Nr. 04 (459)
Prill, 2021

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,
nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.
Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

- 4 Muaji i Ramazanit, muaji i devotshmërisë / Dorian Demetja
- 6 Agjërimi është për Mua dhe Unë shpërblej për të / Qani Sulku
- 8 Lajme / Aktivitete



- 12 Shpresa nuk duhet të vdesë (I) / Nuredin Nazarko
- 14 Pejgamberi Muhammed a.s.m në lartësinë e rangut të tij dhe në madhësinë e lavdisë së tij / Dr. Ali Xhuma
- 18 Dobitë e agjëritit të Ramazanit / Shkëputur nga libri "Ilnihal i zgjeruar", Botim i tre komuniteteve fetare
- 20 Ibn Haldun mbi luksin dhe shkatërrimin e qytetërimeve / Alice Boltoni
- 24 Kush lirohet nga agjërimi / Shkëputur nga libri "Ilnihal i zgjeruar", Botim i tre komuniteteve fetare
- 26 Rekomandimet gjatë agjëritit të Ramazanit tek diabetikët / Prim.dr.med.sci. Ali Iljazi



- 30 Haxhi Hafiz Mahmud Dashi (1873-1961) / Xhemal Balla
- 32 Lartësimi dhe përhapja e qytetërimit islam / Dr. Mozemil Haque
- 34 Efektet psikologjike të agjëritit / Aisa Kokiqi
- 36 A mund t'i zëvendësojmë lotët? / Sinem Akbulak
- 38 Fugëza e shkrëtë dhe të mëdhenjtë



Muaji i Ramazanit

MUAJI I DEVOTSHMËRISË



Profeti Muhamed (a.s.) kur thotë, "Kush agjëron muajin e Ramazanit me besim dhe bindje, i falen të gjitha mëkatet e tij" (Buhari, Muslim), nënkupton që agjërimi duhet të mbahet me ndërgjegje dhe dëshirë të plotë. Obligimet Islame të çdo lloji qofshin, duke futur këtu krahas agjërit, edhe faljen, zekatin, haxhin etj., kryhen në emër të Zotit dhe për hir të Tij. Ka njerëz që e kanë të nevojshme të mbajnë dietë për shkak të mbipeshës. Kjo lloj diete e mbajtur në Ramazan, e ndihmon njeriun në pakësimin e dhjamërave, por nuk ka asnjë ndikim në kalitjen shpirtërore të ndërgjegjes. Agjërimi i Ramazanit që bëhet në emër të Zotit ka shpërblim të madh, sepse shoqërohet me një cikël veprimtarish gjatë gjithë ditës që nga agimi deri në perëndimin e diellit. Qëllimi i agjërit është devotshmëria, është kalitja e ndërgjegjes së njeriut, përsosja e vazhdueshme dhe e pandërprerë e saj, pajisja e muslimanit me virtyte humanitare, me synim që kjo sjellje të praktikohet me ndërgjegje e bindje të plotë dhe me dashuri.


Muaji i Ramazanit është një pastrim për njeriun nga ndotësitë e mëkateve që ka bërë gjatë gjithë vitit, pasi agjërimi në Ramazan është si një dush shpirtëror, në të cilën njeriu hyn një herë në vit për të larë njollat e mëkateve të tij, e për të dalë prej tij më pas krejtësisht i pastër. Ky muaj i bekuar është muaji ku Allahu i shumëfishon shpërblimet për agjëruarit dhe i ngre ata në shkallët e larta të devotshmërisë. Me agjërimin e Ramazanit më së miri shprehet besimi, bindja, sinqeriteti, solidariteti.. virtyte këto të cilat duhet të stolisin çdo besimtar. Me anë të agjërit në këtë muaj, arrijmë të krijojmë jetë më të ngritur shpirtërore, një atmosferë mirëkuptimi, mirësjelljeje, devocioni, një atmosferë bujarie, ndershmërie dhe përgjegjësie, duke i pranuar gabimet dhe duke kërkuar faljen e Zotit. Kjo kohë është kaq e begatë, sa gjumi i agjëruarit vlerësohet si adhurim, kurse heshtja e tij si madhërim i Zotit. Mirësive dhe adhurimeve që bën agjëruari u jepen shpërblime të shumëfishta. Allahu ia pranon lutjet dhe ia fal mëkatet. Lidhur me këtë Profeti Muhamed (a.s.) thotë: "Ai që bën një të mirë gjatë këtij muaji është sikur të ketë kryer një farz (detyrim) në muajt e tjerë. Dhe ai që zbaton një farz këtë muaj, është sikur të kishte kryer shtatëdhjetë farze gjatë muajve të tjerë. Gjesti i dikujt që i servir iftar një të agjëruari mund të bëhet pretekst për faljen e mëkateve të tij

dhe për shpëtimin nga xhehenemi. Në të njëjtën kohë, ky është edhe një pretekst për fitimin e shpërblimit të një agjërimi, pa iu pakësuar shpërblimi aspak ngrënësit të iftarit" (Tirmidhi)

Islami i shikon interesat e shoqërisë mbi interesat e individit. Shërbimi ndaj Zotit bëhet nëpërmjet një jete të pastër në shumëllojshmërinë e shoqërisë. Zoti i ka krijuar njerëzit me kapacitete të ndryshme fizike, emocionale, intelektuale dhe shpirtërore. Ai na ka bërë të gjithëve të kemi nevojë për njëri-tjetrin për përfitime të dyanshme. Nga kjo, nënkuptohet që Ramazani dhe respektivisht agjërimi në këtë muaj ka rëndësi sociale, sepse secili person kërkon me veprimet e tij të dalë në dritë e gjithë shoqëria Islame, duke u bërë kështu të devotshëm, të mirëorganizuar dhe të mirëdisiplinuar. Pra, kjo shoqëri muslimane gjatë këtij muaji, jeton dhe punon sipas kodit hyjnor moral të shkruar në Kur'anin e shenjtë që ka zbritur në këtë muaj. Duke agjëruar, njeriu mënjanon me ndërgjegje ushqimin sipas orarit të caktuar nga agimi deri në perëndim të diellit, largon mendimet dhe sjelljet e pahijshme dhe shton ndjenjën e tolerancës aq të nevojshme për shoqërinë ku jetojmë, duke kontribuar kështu për harmonizimin e raporteve në familje, punë dhe shoqëri.

Të privosh vetveten nga gjërat thelbësore të jetës, nuk është një akt i lehtë. Kjo kërkon një personalitet të fortë për të patur një vetëkontroll, vetëdisiplinë dhe vetëpërmbytje. Ky program vetushtrues gjatë muajit të Ramazanit ka rëndësi të veçantë në jetën e përditshme. Një besimtar që mund të përmbajë veten nga gjërat thelbësore të jetës për një kohë të caktuar dhe kur këtë e bën për hir të dashurisë për Allahun, meriton një shpërblim nga vetë Krijuesi. Prandaj Zoti e konsideron agjërimin të Tijin, në një hadith kudsí të transmetuar nga Ebu Hurejre ku thuhet: "Çdo punë e njeriut është e tij, përveç agjërit. Ai është i lmi dhe vetëm Unë e jap shpërblimin për të. Besimtari e lë ushqimin për Mua, largohet nga gruaja e tij vetëm për Mua dhe braktis dëshirat e tij vetëm për Mua" (Sahihu ibn Huzejme). Krijuesi i Lartë në një tjetër hadith kudsí thotë: "Kush agjëron një ditë për Mua, shpërblimin e tij do e jap Unë" (Buhari). Kjo do të thotë se ky shpërblim i Allahut, nuk llogaritet me njësi matëse apo peshore, por jepet drejtpërdrejt nga Ai, në masën që e di vetëm Ai.

Aqjërimi është për Mua **Unë shpërblej për të**



Përveç ajeteve kuranore të dedikuara për agjërimin, Allahu i Lartësuar na flet për të edhe nëpërmjet të dërguarit të Tij, Muhamedit a.s., dhe këtë e bën në vetën e parë, duke thënë: "Të gjitha punët që bën njeriu, i bën për veten e tij, përveç agjërit, i cili është për Mua dhe vetëm Unë jam Ai që e shpërblen."

Agjërimi i myslimanëve ndryshon nga çdo lloj agjërimi tjetër. Tek krishterimi gjejmë agjërim të llojit: largim nga ushqimi përveç ujit, apo moskonsumimi i disa produkteve ushqimore si psh: mish, ëmbëlsirë, etj. Tek bektashinjtë, agjërimi i njohur është Matemi që zgjat 10 ditë dhe nuk kryhet në të njëjtin muaj me atë të Ramazanit, por përgjatë një tjetër muaji hënor që quhet "Muharrem" dhe specifika e këtij agjërimi është moskonsumimi i ujit. Gjithashtu edhe simbolikat e agjërit tek fetë e tjera ndryshojnë nga qëllimi i agjërit të myslimanëve. Agjërimi i bektashinjve mbahet në shenjë zie për martirët e Qerbelasë. Ndërsa agjërimi i të krishterëve quhet "Kreshmë" që zgjat 40 ditë, ku përgjatë kësaj periudhe duhet hequr dorë nga çdo lloj ushqimi me origjinë shtazore dhe ky lloj agjërimi kryhet në shenjë përkujtimi të 40 ditëve të Jezusit (Isait alejhi selam) të kaluara në shkretëtirë në lutje e agjërim.

Ndryshe nga të tjerët, myslimanët agjërojnë për të përmbushur një urdher hyjnor, të sqaruar qartazi në Kuran, por edhe nëpërmjet të dërguarit Muhamed a.s. Simbolika e tij nuk ka lidhje me ndonjë profet të caktuar apo me ndonjë ngjarje, porse është zbatim i një obligimi, që në fenë islame zë një peshë të madhe, sa që konsiderohet një prej 5 shtyllave bazë të besimit islam. Ndryshe nga të tjerët, agjërimi i myslimanëve konsiston në largimin nga çdo lloj ushqimi e pije, si dhe nga marrëdhëniet intime, brenda harkut kohor nga agimi i ditës e deri në perëndimin e diellit, dhe kjo për një periudhë kohore një mujore. Kjo është një sakrificë që e bën myslimanin, me qëllimin e vetëm për të arritur kënaqësinë e Allahut të Lartësuar, nënshtrimin ndaj Tij, si dhe mbi të gjitha shpërblimin e pakufijshëm për këtë adhurim të veçantë.

Agjërimi, ndryshe nga adhurimet e tjera, kryhet në fshehtësi, pra askush nuk e di, nëse ti agjëron apo jo, derisa ti t'ia bësh të ditur tjetrit me dëshirën tënde. Prandaj dhe ky adhurim, hyn tek ato adhurime që kryhen me sinqeritet dhe me nijet të pastër. Tek adhurimet e tjera, edhe mund të ndodhë që dikush të ndikohet nga njerëzit rreth e përqark dhe imazhi që do që të krijojë dhe të përçojë para tyre, si njeri i devotshëm dhe me besim të fortë. Myslimani i vendosur dhe i paluhatur në veten e tij, heq dorë me kënaqësi nga ushqimi dhe pija për një orar të zgjatur, diku rreth 16 orë në ditë, vetëm e vetëm që t'ia paraqes Zotit bindjen ndaj Tij. Heq dorë nga afrimiteti intim me bashkorten/tin, vetëm e vetëm që t'i tregojë Allahut, që përparësia i takon Atij. Këto dhe të tjera rite që kryhen gjatë muajit të Ramazanit nga besimtarët myslimanë, tregojnë se ata i janë përgjigjur thirrjes së Zotit me gatishmërinë më të plotë të tyre.

Nëse dikush nga mesi i njerëzve, qoftë edhe prej atyre që i duam fort, do të na kërkonte të agjëronim disa ditë, në shenjë dashurie ndaj tij, nuk do e kishim bërë, madje do na dukej si kërkesë absurde. Edhe nëse do të na kërcënonte se do të largohej prej nesh, nëse nuk do t'ia plotësonim këtë kërkesë, prapë se prapë nuk do e kishim bërë. Ndërsa kur kjo ndodh midis robit dhe Zotit, merr tjetër konotacion dhe kryhet në masë të madhe, sa që një botë e tërë mobilizohet bashkarisht për të përshfaqur përlulesinë ndaj Allahut dhe nevojën e madhe për Të. E gjithë kjo vërteton se agjërimi është një adhurim që kryhet nga njeriu ekskluzivisht për Zotin e tij, për Allahun Fuqiplotë. E gjithë kjo dëshmon se rob ka dëshirë të jetë pranë Zotit të tij, e ndjen dobësinë e vet dhe e ndjen gjithashtu fuqinë absolute të Allahut, dhe nëpërmjet këtij adhurimi dëshiron t'i thotë Zotit: Unë dua të afrohem me Ty, nuk dua të jem larg Teje. Njeriu besimtar e ndjen peshën e mëkateve dhe është i sigurt se vetëm Allahu i fal gjynahet, prandaj dorëzohet pa kushte para urdhërit të Tij. Allahu krenohet në mesin e enjëjve me këtë sakrificë të besimtarëve, duke u thënë atyre: Robi për mua la ushqimin, la pijen, u largua nga kënaqësitë trupore, prishi rehatinë e tij. Kështu që, shpërblimin për gjithë këtë do t'ia jap vetëm Unë.

Njerëzit në këtë botë, në raport me të tjerët, ka raste kur ndihen të pavlerësuar, edhe pse kanë bërë shumë për njeri-tjetrin, por kjo s'ka shans të ndodh me Allahun. Ai vlerëson, shpërblen dhe jep më shumë se sa meriton rob. Kjo e bën agjëruenin të mos kursehet në adhurime e vepra të mira, sidomos në Ramazan, kur dihet se shpërblimi jepet nga Ai, që nuk i pakësohet asgjë dhe që është e Tijja çfarë ndodhet në këtë botë dhe në botën tjetër. Allahu na e pranoftë agjërimin dhe çdo punë të mirë të kryer gjatë tij, e mos na privoftë nga amnistia dhe bujaria e Tij, duke na larguar një herë e përgjithmonë nga zjarri i Xhehenemit e duke na bërë prej banorëve të Xhenetit! Amin!





1

PANAIRI I BAMIRËSISË “NËNA, MËSHIRA NË DUART E SAJ, PARAJSA NËN KËMBËT E SAJ”

Në kuadër të 8-Marsit, Zyra e Gruas pranë Komuniteti Mysliman të Shqipërisë zhvilloi panairin e bamirësisë, “Nëna, mëshira në duart e saj, parajsa nën këmbët e saj”, panair i konceptuar në formën e një programi artistik dhe konkursi me gatimin më të mirë.

Aktiviteti u hap me fjalën përshëndetëse të Përgjegjëses së Zyrës së Gruas, njëherazi edhe organizatorja e këtij panairi, znj. Fatma Karaj, e cila falënderoi të pranishmit dhe bashkëpunëtorët që bënë të mundur zhvillimin e këtij aktiviteti bamirësie.

I pranishëm ishte edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili në fjalën e tij vuri theksin te rëndësia që i jep feja islame nënës dhe gruas.

Kryetari Spahiu u shoqërua nga Kancelari i Komuniteti Mysliman të Shqipërisë, z. Ylli Cikalleshi.

Si bashkë organizatore në aktivitet morën pjesë edhe Nënkrjetarja e Bashkisë Tiranë, znj. Anisa Ruseti dhe Drejtoresha e Çështjeve Sociale, znj. Anisa Subashi.

Aktiviteti vazhdoi më tej me vlerësimin e gatimeve më të mira të sjella në panair, të ardhurat e të cilit do të shkojnë për shtresat në nevojë.

2

AMBASADORI I RI I SPANJËS NË SHQIPËRI VIZITON KMSH-NË

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim mirëseardhjeje ambasadorin e ri të Spanjës në vendin tonë, z. Marcos Alonso.

Kryetari Spahiu e njohu ambasadorin me institucionin që ai drejton, rolin e rëndësishëm që luan KMSH në jetën e përditshme dhe harmoninë ndërfaqetare të vendit.

Pasi e falënderoi Kryetarin për mikpritjen, ambasadori Alonso, shprehu vullnetin e tij për të intensifikuar më tej marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve.

“Unë jam besimplotë se ka akoma hapësira për t’i intensifikuar marrëdhëniet ndërmjet nesh pasi jam i bindur që potenciali ekziston dhe roli juaj si komuniteti fetar më i madh në vend është tepër i rëndësishëm në këtë drejtim.” – u shpreh ai.



3

VIZITË E KRYETARIT NË AMBASADËN E ARABISË SAUDITE NË TIRANË

Në kuadër të muajit të shenjtë të Ramazanit, Qendra Barmirëse dhe Humanitare "Mbreti Selman", fondacion zyrtar i Oborrit Mbretëror Saudit dhe tashmë mik tradicional i KMSH, me anë të Ambasadës së Arabisë Saudite në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, do të shpërndajnë 25 ton hurma arabe.

Nisur nga kjo, kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, vizitoi Ambasadorin e Arabisë Saudite në Tiranë, z. Abdul-Mu'min Muhamed Sharaf.

Kryetari Spahiu, e falënderoi ambasadorin për dhurimin e 25 ton hurmave si dhe vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet KMSH-së, Ambasadës së Arabisë Saudite dhe Qendrës "Mbreti Selman", bashkëpunim i cili është konkretizuar me disa projekte humanitare.

Ndërsa ambasadori Sharaf, shprehu vullnetin e tij për vazhdimësinë e kësaj fryme bashkëpunimi ndërmjet 3 institucioneve. Shpërndarja e hurmave ka filluar dhe po realizohet me anë të myftinive në çdo qytet të Shqipërisë.

4

PJESËMARRJA E KRYETARIT BUJAR SPAHIU NË KONFERENCËN "DIALOGU NDËRMJET FEVE DHE KULTURAVE" NË EGJIPT

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, me ftesë të Ministrisë të Çështjeve Fetare të Egjiptit, z. Muhamed Mukhtar Xhuma, merr pjesë në konferencën ndërkombëtare të organizuar në Egjipt, me temë: "Dialogu ndërmjet feve dhe kulturave", konferencë e cila zhvillohet nën kujdesin e Presidentit të Republikës së Egjiptit, Shkëlqesisë së Tij, Abdulfetah el-Sisi.

Pjesëmarrësit në këtë konferencë janë kryesisht personalitete dhe dijetarë, drejtues institucioneve fetare, studiues, ministra të çështjeve fetare nga vende të ndryshme të botës.

Gjatë punimeve të konferencës, z. Spahiu ishte ndër panelistët e përzgjedhur, ku mbajti kumtesën e tij, në të cilën theksoi rëndësinë e dialogut ndërfetar për njerëzimin dhe u shpreh se Shqipëria me harmoninë ndërfetare që ka është një model për rajonin dhe Evropën.

Gjithashtu kryetari Spahiu dha disa intervista për televizione e media të ndryshme.





5

TAKIM ME DREJTORIN E MARDHËNIEVE ME JASHTË TË BASHKËSISË ISLAME TË BOSNJE DHE HERCEGOVINËS

Kryetari i Komuniteti Mysliman të Shqipërisë priti në një takim Drejtorin e Mardhënieve me Jashtë të Bashkësisë Islame të Bosnje dhe Hercegovinës, z. Razim Kolic dhe ndihmësen e tij, znj. Azra Efendic Eminovic.

Bashkëpunimi i deritanishëm ndërmjet Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe atij të Bosnje dhe Hercegovinës në fusha të ndryshme me natyrë fetare, aktivitetet e përbashkëta si konferenca, shkëmbime eksperiencash, por edhe mbështetja që Bashkësia Islame e Bosnje-Hercegovinës i ka dhënë Komunitetit Mysliman në rastin e fatkeqësisë natyrore të tërmetit që goditi vendin tonë në nëntor të vitit 2019, ishin ndër temat kryesore të bashkëbisedimit.

Kryetari Spahiu i falënderoi miqtë nga Bosnja dhe shprehu vendosmërinë që marrëdhëniet dypalëshe të vijnë duke u intensifikuar edhe më tej në funksion të shërbimit fetar dhe përcimit të mesazhit paqësor të Islamit në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë dhe mbarë Rajonin.

Mysafirët shprehën mirënjohjen e tyre për pritjen nga Kryetari i KMSH-së dhe i përcollën atij urimet e përzemërta të Kryetarit të Bashkësisë Islame të Bosnje dhe Hercegovinës, z. Husein Kavazovic.

6

NDERIMI I KËSHILLIT NDËRFETAR TË SHQIPËRISË ME DEKORATËN E LARTË “NDERI I KOMBIT”

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në ceremoninë e vlerësimit të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë me Dekoratën e lartë “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta.

Dekorata e lartë “Nderi i Kombit”, u dha me motivacionin:

“Në vlerësim të kontributit të gjithanshëm në ruajtjen dhe promovimin e frymës së harmonisë, mirëkuptimit e bashkëjetesës midis feve në Shqipëri. Për mesazhet e qarta drejtuar besimtarëve e politikës shqiptare që të synojnë paqen, bashkimin, përparimin e orientimin drejt vlerave atdhetare për një jetë të përbashkët e optimiste; si dhe për rolin e rëndësishëm në lartësimin e modelit shqiptar të dialogut ndërfetar në arenën ndërkombëtare”.

Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta vlerësoi në fjalën e tij rolin e liderëve fetarë në vend dhe rëndësinë e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë.



7

**VIZITË NGA DREJTORI I RI I BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË (UBA),
Z. AMEL KOVAČEVIĆ**

Drejtori i ri i Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (UBA), z. Amel Kovačević, ishte për një vizitë kortezie në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, ku u prit nga kreu i KMSH-së, H. Bujar Spahiu.

Pasi e njohu z. Kovačević me veprimtarinë e KMSH-së, Kryetari Spahiu i shprehu atij urimet për detyrën e re dhe vullnetin për të intensifikuar marrdhëniet ndërinstitucionale në drejtimet me interes të përbashkët.

Kovačević në vitet e fundit ka gërshetuar një karrierë në sektorin bankar me detyra politike dhe diplomatike. Para se të merrte drejtimin e UBA, ai ka qenë ministër i Financave i Kantonit të Sarajevës, ndërsa në periudhën 2010-2013, ka mbajtur detyrën e Ambasadorit të Bosnjës në Kinë dhe Mongoli.

UBA kontrollohet në masën 72.2% nga Banka Islamike për Zhvillim dhe operon mbi parimet e bankut islamik.

8

**SIMPOZIUMI NDËRKOMBËTAR ME TITULL: “SFIDAT E KOMUNITETEVE MYSLIMANE NË
VENDET E EVROPËS LINDORE NË KOHËN E PANDEMISË”**

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Islame, Bedër dhe Këshillin Botëror të Komuniteteve Myslimane, organizuan simpoziumin ndërkombëtar me titull: “Sfidat e Komuniteteve Myslimane në Vendet e Evropës Lindore në kohën e Pandemisë”.

Pjesëmarrës në këtë simpozium ishin: H. Bujar Spahiu, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Dr. Mohamad Bechary, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit Botëror për Komunitetet Myslimane, me seli në Emiratet e Bashkuara Arabe, Shejh Akhmed Tamim, Myftiu i Ukrainës, Dr. Enver Gicic, Dekan i Fakultetit të Studimeve Islame, Sanxhak, Serbi, Dr. Giasiar Serif Damadoglu, ish Zëvendës Myfti, Profesor i Shkencave Islame, Greqi, Besim Mehmeti, Bashkësia Islame e Kosovës, Dr. Jamal Safarty, KU Bedër, Shqipëri dhe Hysni Skura, Moderator, KU Bedër, Shqipëri.

Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, në cilësinë e bashkorganizatorit të këtij simpoziumi rajonal, vuri theksin në sfidat dhe sjelljen e re që na u desh të fitojmë për të vazhduar aktivitetin tonë fetarë edhe në kushte të tilla.



Shpresa **NUK DUHET TË VDESË (I)**

Frika për të ardhmen gjithmonë është prezente tek njeriu. Sado forma dhe ngjyra të marrë interpretimi i saj, në thelb mbetet frikë nga humbja e mundësisë për të shijuar të përkohshmen. Frika është natyrore tek njeriu. Lind bashkë me të. Vdes bashkë me të. Zhvillohet sipas situatave dhe rrethanave në të cilat gjendet njeriu. Forcohet. Dobësohet. Humbet. Rishfaqet përgjatë gjithë përkohësisë. Shpesh gjeneron mbrojtje. Po kështu gjeneron edhe thellim në ligësi. Në të dy rastet vepron si mekanizëm mbrojtës për të mbajtur pas vetes atë që nuk dëshiron ta humbësh, edhe pse në rastin e dytë kjo lidhet me ligësinë.

Frikë nga varfëria. Njeriu përdor energjitë e tij për të përmirësuar kushtet materiale të të jetuarit. Çdo ditë të jetës ky mbetet një shqetësim. Sot kemi më pak, por nesër duhet të kemi më shumë. Rrit numrin e orëve të punës. Edhe nëpër ëndrra sheh rritje të shifrave në numrin e llogarisë. Dalëngadalë si pa u kuptuar përfshihet nga vorbulla e të jetuarit perfekt, pasi po të kesh para çdo gjë bëhet e mundshme. Që njeriu të punojë e të përmirësojë jetën e vet edhe materialisht jo vetëm që nuk ka asgjë të keqe, por është domosdoshmëri për t'u shkëputur nga kthetrat e varfërisë, pasi gjendja e varfërisë është shumë më tepër shaktërruese për dinjitetin dhe personalitetin e njeriut se gjendja e pasurisë. Por e keqja qëndron kur pasurimi kthehet në qëllimin kryesor të jetës, dhe përball këtij qëllimi nuk njih më as nënë e babë. Për të ruajtur vetveten nga thithja e batakut duhet hedhur me kujdes çdo hap jetësor. Njeriu duhet të mendojë pastaj të veprojë, dhe jo të veprojë pa mendim e pastaj të vajtojë për pasojat.

Të qenit i pasur nuk e zhbën frikën nga varfëria. Përtej sigurisë në dukje që të ofron pasuria, jeta është shumë surprizuese. E ardhmja e panjohur mund të sjellë gjendje të padëshiruara dhe nga i pasur të gdhiesh i varfër, nga i varfër të gdhiesh edhe më i varfër. Frika se mund të humbasësh atë që zotëron sjell shqetësim dhe ankth. Njeriu nuk e dëshiron këtë gjendje, por nuk mund ta mposhtë natyrshmërinë e vet. Kjo frikë nuk zhduket asesi. Dhe kur njeriu ka frikë nga varfëria bëhet më zemërngushtë, dorështërnguar, më pak njerëzor, më pak i mëshirshëm e i butë në raport me ata që kanë nevojë për t'u ndihmuar. Njeriu që vishet më

këtë kostum, sado bukur t'i jetë prerë e sado ngjyra të shkëlqyera të ketë, mbetet antipod i vlerave. Përballë frikës nga varfëria nuk duhet të stepemi dhe të ndryshojmë vetvetet duke i hedhur në prehërin e zemërngushtësisë. Por në të njëjtën kohë nuk duhet të hidhemi as në prehërin e dorëlëshimit. Duhet synuar një mesatari e cila as nuk të lejon të biesh në gjendjen e varfërisë për shkak të dorëlëshimit, por as nuk të tjetëron në zemërngushtë për shkak të frikës nga varfëria. Lufta ndaj frikës nga varfëria është luftë edhe kundër vetë varfërisë, pasi kush jep e ndihmon pa dëmtuar veten është njeri që jo vetëm mbart vlera, por mbi të gjitha tregon se vlerat kanë vlerë kur jetësohen praktikisht me qëllime të pastra.

Frikë nga uria. Lëndorja është domosdoshmëri tek njeriu, por jo thelbësore. Njeriut i duhet ushqimi fizik që të jetojë fizikja. Thelbësor mbetet ushqimi shpirtëror që i jep njeriut kuptimin si qenie njerëzore. Pa këtë njeriu zbrit në stade të ulëta të nënshtrimit ndaj instikteve dhe dëshirave. Njeriu nuk mund të zhdukë as instiktet, as dëshirat. Janë vlerat morale ato që shenjojnë mënyrën se si duhen përmbushur instiktet, dëshirat, pasionet. Kërkesa për të mbushur stomakun është instiktive. Me çfarë do të mbushet, si do të mbushet dhe sa do të mbushet e vendos njeriu. Me drejtësi apo jo. Uria nuk është gjendje që shoqëron vetëm të varfërin. Natyrisht nuk është vetëm uri për ushqim. Por frika nga uria për ushqim është më e fortë sepse lidhet me mbijetesën. Kur njeriu mbërthehet nga frika se do të mbetet i uritur dhe uria do t'i marrë jetën, atëherë arrin në pikën ku çdo lloj nënshtrimi nuk i bën aspak përshtypje, çdo lloj pasurie nuk i hyn në sy. I mjafton mbijetesa si luksi më i madh. Nevoja për ushqim e bën të përkulshëm ndaj çdo lloj autoriteti që do t'i sigurojë ushqim. Nënshtrim dhe skllavërim për hir të ushqimit. Shuaftja e urisë dhe eliminimi i frikës prej saj zhdukin çdo lloj rebelimi ndaj autoritetit që sundon me tirani. Dinjiteti humbet dhe njeriu tashmë është shndërruar në një mekanizëm uzine që pret lëndën e parë për përpunim. Por a mund të pranohet kjo gjendje? Çlirimi nga e keqja nuk arrihet pa durim e sakrificë. Nëse njeriu i nënshtrohet lëndores, shpirtërorja është tepër e dobët. Për të shpëtuar nga kjo gjendje e mjerueshme, qoftë edhe kur jemi të pasur, ka vetëm një rrugë, ringjallje shpirtërore.

Pejgamberi Muhammed a.s.m

NË LARTËSINË E RANGUT TË TIJ DHE NË MADHËSHTINË E LAVDISË SË TIJ

“

“Nuk do të mund të kuptohej Personaliteti i Muhammedit në të gjitha aspektet e tij, sepse ai është: “Muhammedi Profet, Muhammedi luftëtar, Muhammedi tregtar, Muhammedi burrë shteti, Muhammedi predikues, Muhammedi reformator, Muhammedi streha e jetimëve, Muhammedi çliruesi i grave, Muhammedi gjykatësi....; të gjitha këto role madhështore e kualifikojnë atë për të qenë hero.”

Profesor Makrishna, nga vepra “Muhammedi Profet”

MËSHIRA E DHURUAR PËR NJERËZIMIN

Profeti Muhamed a.s.m ka një pozitë të madhërishe dhe një vlerë shumë të lartë; ai i ka tejkaluar të gjitha krijesat. Ai është prijësi i bijve të Ademit a.s, madje është prijësi i të gjitha qënieve dhe maja e tyre. Ai është më i mirë se engjëjt dhe më i mirë se Froni Sublim; dhe askush nuk e di realitetin e tij dhe as madhësitinë e vlerës së tij përveç Krijuesit të tij.

Zoti ynë e ka dalluar atë me veçori të shumta. Krijuesi ynë e ka lëvdur atë me shumë lëvdata; ndonjëherë e ka lavdëruar në mënyrë të përmblodhur dhe ndonjëherë tjetër në mënyrë të hollësishme duke e përmendur nëpërmjet cilësive më të larta në Kur'anin e Shenjtë. Madje Zoti ynë nuk e thirri kurrë atë thjesht me emrin e tij ashtu siç i thirri profetët para tij, por gjithmonë i adresojë në mënyrë solemne: "O Pejgamber!", "O Ti i mbështjellë me rroba!", "O Ti i mbuluar me rroba!"

Krijuesi ynë e ka lavdëruar atë me cilësi fisnike në Librin e Tij. Krijuesi ynë e përshkroi atë si mëshirë dhe tha: "Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhammed a.s.m) veçse mëshirë për të gjitha botët" (El- Enbija, 21: 107). Gjithashtu Zoti ynë tha: "Vërtet që ju ka ardhur juve një i Dërguar (Muhammedi a.s.m) nga vetë ju (të cilin ju e njihni fare mirë). Ai pikëllohet nëse juve ju bie ndonjë lëndim a vështirësi. Ai është i merakosur dhe i dëshiruar për ju. Për besimtarët ai (a.s.) është i dhembshur dhe mëshirues" (Teube, 9: 128). Gjithashtu Zoti ynë e përshkroi atë si Dritë udhëzuese për tek e vërtetë dhe tha: "O Pejgamber! Me të vërtetë që Ne të kemi dërguar ty dëshmuar, edhe përgëzues, edhe këshillues; edhe si ftues për tek Allahu me Vullnetin e Tij dhe si një Llambë dritëdhënëse" (El- Ahzab, 33: 45-46). Gjithashtu Allahu xh.sh tha: "O ithtarë të Librit (të Shkrimeve të Shenjta)! Tani ka ardhur te ju i Dërguari ynë (Muhammedi a.s.m) duke ju shpjeguar mjaft prej atyre gjërave që ju i keni fshehur gjithnjë nga Libri juaj ose i keni kaluar shumë të tjera. Vërtet që ju ka ardhur nga Allahu një Dritë dhe një Libër i Qartë"(El-Ma'ideh, 5: 15).

GJYMTYRËT E LARTËSUARA TË PEJGAMBERIT A.S.M JANË PËRMENDUR NË KUR'AN

Kushdo që do të sillte portretizimet me të cilat Allahu xh.sh e dalloj peygamberin e nderuar duke përmendur në Kur'an shumë prej gjymtyrëve të tij të lartësuar, do të kuptonte se nuk ka ndodhur kurrë për asnjë melek të afërt (me Zotin) dhe as për ndonjë profet të dërguar që Allahu xh.sh. t'i ketë lavdëruar gjymtyrët dhe cilësitë e tyre në mënyrë kaq të hollësishme.

Zoti ynë e përmendi fytyrën e tij të nderuar a.s.m në Librin e Tij të Madhërishtëm. Aspekti i lavdërimit këtu është thjesht nëpërmjet kthimit të fytyrës së tij të nderuar a.s.m. Allahu xh.sh. ia dhuroi atë çfarë ai a.s.m dëshoi pa e kërkuar dhe pa fjalë. Bekimi i fytyrës së tij nëpërmjet kthimit të saj ishte një dhuratë shpirtbutësie për atë që e dëshiroi dhe një arritje për atë ndaj të cilës ai ishte i kënaqur.

Fytyra e profetit është përmendur në shumë vende të

tjera. Allahu xh.sh thotë: "Ktheje fytyrën tënde në drejtim të Mesxhidil- Haramit (Xhamisë së Shenjtë në Mekë)". (El-Bekareh, 2: 144). Gjithashtu Allahu xh.sh. tha: "Prej ngado që ta nisësh (faljen) ktheje fytyrën nga Mesxhidil- Harami". (El-Bekareh, 2: 149). Gjithashtu Allahu xh.sh. tha: "Kështu, në qoftë se ata të kundërshtojnë ty (Muhammed a.s.m), thuaju: "Unë ia kam nënshtuar fytyrën time plotësisht Allahut, dhe po kështu edhe ata që më ndjekin mua..." (Al-Imran, 3: 20). Gjithashtu, Allahu xh.sh tha: "Ktheje fytyrën tënde plotësisht drejt Fesë Hanifen (Islamit të pastër)". (Junus, 10: 105). Gjithashtu, Allahu xh.sh tha: "Kështu vëre fytyrën tënde në fenë e drejtë e të vërtetë". (Er- Rum, 30:43).

Allahu xh.sh. ka përmendur edhe dy sytë e tij a.s.m dhe tha: "Mos i drejto sytë e tu nga kënaqësitë që Ne ua kemi dhënë disave prej tyre..." (El-Hixhr, 15: 88). Gjithashtu Allahu xh.sh tha: "Dhe mos i hiq sytë mënjanë prej tyre". (El-Kehf, 18: 28). Gjithashtu, Allahu xh.sh. tha: "Mos i hidh sytë në të mirat kalimtare që Ne ua kemi dhënë disave prej tyre". (Taha, 20: 131).

Krijuesi ynë gjithashtu e ka përmendur shikimin e tij (a.s.) në disa vende dhe tha: "Vërtet që ai (Muhamedi a.s.m) shikoi prej shenjave të Zotit të tij më të mëdhatë"! (En-Nexhm, 53: 18). Në këtë ndodhet një lavdërim për shikimin e tij a.s.m dhe një lëvdatë për atë çfarë ai pa prej Shenjave të cilat nuk i ka parë askush para tij. Allahu xh.sh. u tha mushrikëve –politeistëve- duke i penguar ata që të mos e përgënjeshtrojnë atë, lidhur me atë që ai pa: "A do të haheni me të për çfarë ai pa (gjatë Natës së Miraxhit)"? (En-Nexhm,53:12). Pastaj, Krijuesi ynë njoftoi se peygamberi i Tij u posaçërua për të parë Hazreti Xhebrailin a.s në formën e tij origjinale dhe tha: "Dhe vërtet që ai (Muhamedi a.s.m) e pa atë (Xhibrilin) në një zbritje tjetër (edhe një herë tjetër)". (En-Nexhm, 53: 13). Gjithashtu, Krijuesi ynë e përmendi shikimin e tij (a.s.) në disa vende në Librin e Tij të Lartë dhe tha: "Shikimi i tij (Muhamedit a.s.m) nuk u lëkund dhe as nuk e kaloi kufirin (e përcaktuar për të)". (En- Nexhm,53:17). Në këtë kontekst ndodhet një lëvdatë mbi përmendjen, meqë Krijuesi ynë e lavdëroi shikimin e tij dhe se ai ishte i vërtetë dhe jo i lëkundur. Gjithashtu, Allahu xh.sh tha: "Shpejt ti do ta shohësh dhe ata do ta shohin". (El-Kalem, 68: 5). Gjithashtu, Allahu xh.sh tha: "Vështroji ata dhe ata do ta shohin (ndëshkimin)". (Es-Saffat,37: 175).

Gjithashtu, Allahu xh.sh. ka përmendur veshin e tij (a.s.) në shumë vende, dhe tha: "Thuaju: "Ai dëgjon çfarë është më e mirë për ju. Ai beson në Allahun; ai ka besim tek besimtarët dhe është mëshirë për ata nga mesi juaj të cilët besojnë". (Teube, 9: 61). Gjithashtu, Krijuesi ynë përmendi dëgjimin e tij fisnik në disa vende të Kur'anit Kerim, dhe tha: "Ti nuk do të dëgjosh tjetër, veç pëshpëritjes". (Taha,20: 108).

Krijuesi ynë përmendi, gjithashtu, të folurën e tij (a.s.) dhe e lëvdoi duke thënë: "Ai nuk flet sipas qejfit të vet". (En-Nexhm, 53: 3). Gjithashtu, Allahu xh.sh sqaroi vërtetësinë e fjalës së tij (a.s.) dhe saktësinë e thënies së tij.

Gjithashtu, Krijuesi ynë lëvdoi zërin e tij me vlerësim e

madhërim dhe i paralajmëroi sahabët-shokët e profetit – që të mos e ngrënë zërin më lart se ajo masë, dhe tha: “Mos e ngrini zërin tuaj përmbi zërin e pejgamberit...” (El-Huxhurat, 49:2).

Allahu xh.sh. e ka përmendur edhe gjuhën e tij fisnike (a.s.) në shumë vende të Kur'anit, dhe tha:

“Ne e kemi bërë atë (Kur'anin) të lehtë, në gjuhën tënde, vetëm që, nëpërmjet tij, ti t'u japësh lajmin e mirë besimtarëve të devotshëm dhe të paralajmërosh njerëzit kokëfortë (në mosbesimin e tyre)”. (Merjem, 19: 97). Gjithashtu Krijuesi ynë tha: “Ne e kemi bërë të lehtë Kur'anin në gjuhën tënde, që ata të mund të marrin këshilla”. (Ed-Duhan, 44: 58). Gjithashtu, Allahu xh.sh. tha: “Mos nxito (O Muhamed a.s.m) në leximin e Kur'anit me gjuhën tëndel! (El-Kijameh, 75: 16).

Krijuesi ynë ka përmendur edhe kraharorin e tij të lartësuar në shumë vende të Kur'anit, dhe tha: “Vallë, a nuk ta hapëm ty (Muhamed a.s.m) kraharorin (për të pranuar besimin). (Esh-Sherh, 94: 1).

Këtu aludohet për njërën prej mirësive të Allahut mbi të dhe për avantazhin e tij me hapjen e kraharorit. Gjithashtu Krijuesi ynë, duke qetësuar të dashurin e Tij të përzgjedhur, El-Mustafa, tha: “Le të mos ketë kurrfarë shtrëngimi në kraharorin tënd për shkak të tij! Ai të është shpallur, që nëpërmjet tij të paralajmërosh jobesimtarët dhe të këshillosh besimtarët”. (El-A'raf, 7:1). Gjithashtu Allahu xh.sh. e përmendi kraharorin e tij për ta argëtuar duke thënë: “Mund të ndodhë që ti (Muhammed a.s.m) të lësh mënjane diçka nga ato që të janë shpallur ty dhe të të ngushtohet kraharori, sepse ata thonë: “Përse nuk i është dërguar ndonjë thesar?” Ti je vetëm paralajmërues e Allahu kujdeset për çdo gjë”. (Hud, 11: 12). Allahu xh.sh. e ka përmendur kraharorin e tij në një kontekst tjetër me qëllim që ta forcojë e ta bëjë të qëndrueshëm, dhe tha: “Ne e dimë mirë, që ty të ngushtohet kraharori nga fjalët e tyre”. (El-Hixhr, 15: 97). Allahu xh.sh. gjithashtu ka përmendur edhe zemrën e tij fisnike në shumë vende të Kur'anit dhe e përfshiu përmendjen në lavdërimin për të (a.s.) duke thënë: “Thuaju (O Muhamed a.s.m) atyre që janë armiq të Xhebrailit, se ai e ka zbritur Kur'anin në zemrën tënde me Lejen e Allahut, si vërtetues të Librave të Shenjtë të mëparshëm dhe si udhërrëfyes e sihariq për besimtarët”. (El-Bekare, 2: 97).

Gjithashtu, krijuesi ynë tha: “Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (O Muhamed a.s.m). Sikur të ishte i ashpër në zemër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje...”. (Al-Imran, 3:159). Gjithashtu, Allahu xh.sh. tha: “Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhebraili) në zemrën tënde që të jesh nga ata që paralajmërojnë”. (Esh-Shuara, 26: 193-194). Madje krijuesi ynë e lëvdoi shumë zemrën e pejgamberit të Tij kur pohoi se zemra e tij (a.s.) është më e fortë se malet në mbajtjen e zbulesave Hyjnore dhe të shpalljes, dhe tha: “Sikur këtë Kur'an t'ia shpallnim ndonjë mali, ti do ta shihje atë (mal) të përlulur dhe të copëtuar nga frika e Allahut. Shembuj të tillë Ne ua japim njerëzve që ata

të meditojnë”. (El-Hashr, 59:21). Krijuesi e shpalli Kur'anin në zemrën e tij (a.s.) dhe ajo mbajti atë çfarë nuk mund ta mbante mali i fortë e i lartë.

Allahu xh.sh. e posaçëroi zemrën e tij fisnike (a.s.) me përmendje në Kur'anin e Shenjtë duke përfshirë lavdërimin ndaj zemrës së tij (a.s.) dhe tha: “Zemra (e Muhamedit a.s.m) nuk gënjen për atë që ka parë”. (En-Nexhm, 53: 11). Gjithashtu Krijuesi ynë tha: “Ne po t'i tregojmë ty disa nga historitë e të dërguarve, për të ta forcuar zemrën”. (Hud, 11: 120). Gjithashtu, Allahu xh.sh. tha: “...Ne ta kemi shpallur kështu për të forcuar zemrën tënde dhe ta kemi zbuluar qartazi varg pas vargu”. (El-Furkan, 25: 32).

Gjithashtu Krijuesi ynë ka përmendur edhe kurrizin e Pejgamberit Muhamed a.s.m, dhe në kontekstin e mirënjohjes për të, tha: “...E cila ta rëndonte tepër kurrizin”. (Esh-Sherh, 94: 3).

GJENEALOGJIA E TIJ FISNIKE

Allahu xh.sh. i ka përmendur veçoritë dhe lidhjet e origjinës së nderuar të pejgamberit pa përmendur anëtarët e saj fisnikë dhe e ka lavdëruar atë. Prej këtyre veçorive është prejardhja e tij fisnike. Allahu xh.sh. tha: “Dhe lëvizjet e tua mes atyre që bien në sexhde”. (Esh-Shuara, 26: 219). Rrëfëhet nga Ibnu Abbasi, Allahu qoftë i kënaqur me të, i cili tha lidhur me fjalën e Allahut, “Dhe lëvizjet e tua mes atyre që bien në sexhde”, se kjo ka kuptimin “Nga palcat e baballarëve, të parëve, Ademit, Nuhut, Ibrahimit deri kur e nxori si pejgamber”. Kështu, Muhamedi a.s.m ishte më i nderuari i pejgamberëve midis popujve të tyre dhe ishte më fisniku i njerëzve në mënyrë absolute. Ashtu siç njoftoi vetë ai (a.s.), rrëfëhet nga Vail Ibnu Eska se Profeti Muhamed a.s.m ka thënë: “Allahu i madhërishëm, ndër bijtë e Ibrahimit, zgjodhi Ismailin. Nga bijtë e Ismailit zgjodhi bijtë kinane. Nga bijtë kinane zgjodhi kurejshët. Nga kurejshët zgjodhi bijtë Hashim. Nga bijtë Hashim zgjodhi bijtë Abdulmuttalib. Dhe nga bijtë Abdul Muttalib më zgjodhi mua”. (Muslim, Fedail; Tirmidhi, Merakib). Gjithashtu rrëfëhet nga xhaxhai i tij Abbasi se Profeti Muhamed a.s.m ka thënë: “Allahu i krijoi qeniet dhe më bëri mua më të mirin prej tyre; pastaj përzgjedhi fiset dhe më bëri mua prej më të mirit fis; pastaj përzgjedhi shtëpitë dhe më bëri mua prej më të mirës së shtëpive të tyre; kështu unë jam më i miri i tyre si individ dhe më i miri i tyre si shtëpi”. (Transmeton Tirmidhiu).

Ai është Prijësi ynë Ebul Kasim Muhammed Ibn Abdullah Ibn Abdil Muttalib ibn Hashim Ibn Abdil Menaf Ibn Kusaj Ibn Kilab Ibn Murr-re Ibn Ka'b Ibn Luej Ibn Galib Ibn Fihri Ibn Malik Ibn Nadr Ibn Kinane Ibn Hudhejme Ibn Mudrike Ibn Ilias Ibn Mudar Ibn Nidhar Ibnu Meadd Ibn Adnan. (Buhari, Menakibul Ensar). Kurse nëna e tij ishte Amineja Bintul Veheb Ibnul Menaf Ibnu Zuhreh Ibnul Kilab, i përmendur në linjën e prejardhjes së tij (a.s.) i cili ishte i pesti prej stërgjiyshërve të tij.

Një prejardhje e tillë, erdhi mbi të si një rrezatim prej diellit të mëngjesit, si një kolonë drite prej agimit; në të

nuk ka tjetër veçse prijës prej prijësit duke mbajtur virtytet, fetarinë dhe bujarinë.

Gjithashtu Allahu xh.sh. e lartësoi shumë jetën e pejgamberit të Tij dhe jetëgjatësinë e tij në tokë, saqë u betua për të në Kur'an dhe tha: "Vërtet (Betohe) për jetën tënde (O Muhamed), në marramendjen e tyre të egër, ata po endeshin të verbuar në çmenduri". (El-Hixhr,15: 25).

Gjithashtu Zoti ynë e lartësoi shumë vendin në të cilin qëndroi pejgamberi ynë i nderuar dhe duke lëvdur vendin e të Dashurit të Tij, tha: "Betohe Unë për këtë qytet (Mekën)! Dhe ti je i lirë në këtë qytet!". (El-Beled, 90: 1-2)

Krijuesi ynë i lëvdoi edhe gratë e tij; dhe ato nuk e arritën këtë shkallë vlerësimi veçse për shkak të lidhjes së tyre me pejgamberin e përzgjedhur, El-Mustafa, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të. Zoti xh.sh. tha: "O gratë e Pejgamberit! Ju nuk jeni si çdo grua tjetër". (El-Ahzab, 33: 32). Gjithashtu Krijuesi ynë, me të njëjtin kuptim, tha: "Dhe bashkëshortet e tij janë nënat e tyre". (El-Ahzab, 33: 6).

KREMTIMI I MEVLUDI SHERIFIT

Me të vërtetë, lindja e Pejgamberit të nderuar ishte një shfaqje e Mëshirës Hyjnore në lidhje me të gjithë njerëzimin. Kur'ani Kerim u shpreh për ekzistencën profetike se ajo është "Mëshirë për botërat". Kjo mëshirë nuk është e kufizuar. Ajo përfshin edukimin e njerëzimit, pastrimin e tyre, arsimimin e tyre, udhëzimin e tyre për tek Rrugë e Drejtë dhe përparimin e tyre në nivelin e jetës së tyre materiale dhe shpirtërore; ashtu siç nuk kufizohet ajo mëshirë vetëm tek njerëzit e asaj kohe, por shtrihet me shtrirjen e të gjithë historisë, "Dhe Ai e ka dërguar atë (Pejgamberin Muhamed a.s.m) edhe tek të tjerët prej atyre të cilët akoma nuk u janë bashkuar atyre....". (El-Xhumuah, 62: 3)

Kremtimi i përkujtimit të lindjes së Prijësit të të dyja botëve, Vulës së pejgamberëve dhe të dërguarve, Profetit të mëshirës, Ndihmës së Ummetit, Prijësit tonë Muhamed a.s.m është prej veprave më të mira dhe prej akteve më të mëdhaja që të afrojnë tek Allahu xh.sh., sepse ai kremtim shpreh gëzimin dhe dashurinë për pejgamberin a.s.m dhe dashuria për të është njëra prej bazave të besimit. Rrëfëhet një hadith i saktë nga profeti Muhammed a.s.m i cili tha: "Asnjëri prej jush nuk beson derisa unë të jem për të më i dashur sesa fëmija e tij, se babai i tij dhe se të gjithë njerëzit" (Transmeton Buhari). Ibn Rexheb ka thënë: "Dashuria për pejgamberin është njëra prej bazave të besimit. Ajo është bashkëshoqëruese e dashurisë për Zotin xh.sh; Allahu e ka përcaktuar atë dhe ka kërcënuar cilindo që, mbi ato të dyja, i jep përparësi në dashuri diçkaje tjetër prej gjërave të dashura në mënyrë të natyrshme prej të afërmeve, pasurive, vendbanimeve dhe gjërave të ngjashme me këto, dhe tha: "Thuaju (O Muhamed a.s.m): "Në qoftë se baballarët tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, të afërmit tuaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë, dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij,

atëherë pritni derisa Allahu të sjellë vendimin(dënimin) e Tij". (Teube, 9: 24). Kur Hazreti Umeri i tha pejgamberit: "Ti je më i dashur për mua sesa çdo gjë tjetër, përveç vetes sime. Profeti i tha: "Jo, o Umer, derisa unë të jem më i dashur për ty sesa vetja jote". Atëherë Umeri tha: "Betohe për Allahun se ti tani je më i dashur për mua sesa vetja ime"; Profeti tha: "Tani, O Umer!" (Transmeton Buhari).

Kremtimi i mevludit është nderim për pejgamberin dhe nderimi për të është urdhër i prerë i ligjshëm, sepse ai nderim është themeli bazë dhe kolona e parë. Allahu xh.sh. e njohu vlerën e pejgamberit të Tij dhe ua bëri të njohur të gjitha qenieve emrin e tij, vendin ku do të dërgohej, pozitën dhe rangun e tij. Kështu, të gjitha qeniet janë në gëzim të vazhdueshëm dhe në ëndje absolute nëpërmjet dritës së Zotit, kënaqësisë së Tij, mirësisë së Tij për botërat dhe për provën e Tij.

Qysh prej shekujve të katërt dhe të pestë, të parët tanë, Selefuna, e kanë ndjekur e zhvilluar traditën e kremtimit të mevludit sherif, lindjes së pejgamberit më të madh, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, duke e kaluar të zgjuar natën e lindjes së pejgamberit duke kryer të gjitha llojet e akteve që të afrojnë tek Zoti, të tilla si, dhënia ushqim të varfërve, lexim Kur'ani, recitim dhikri e tesbihati, këndim ilahish e recitim poezish në lavdërim të Profetit Muhamed a.s.m, ashtu siç e përmendin këtë shumë historianë si shembulli i ruajtësve të haditheve- Hafidhinëve-të tillë si, Ibnu Xheuzi, Ibnu Kethiri, Hafidh Ibnu Dihijeh El-Andulus, Hafidh Ibn Haxher dhe Vula e Ruajtësve të Haditheve Xhelaluddin Es-Sujuti, Allahu i mëshiroftë të gjithë ata.

Një grup prej dijetarëve dhe Fukahave hartuan vepra lidhur me parapëlqimin –Istihbab- të kremtimit të mevludit sherif dhe sollën argumente të saktë për parapëlqimin e kësaj pune, saqë për dikë që ka arsye, perceptim e mendim të shëndoshë nuk do të mbetej më asgjë për të mohuar kremtimin e përkujtimit të lindjes së pejgamberit Muhamed, veprim të cilin e ndoqën të parët tanë të drejtë-Selefuna Sa'lih. Ibnul Ha'xh foli gjërë e gjatë në veprën "El-Med'hal" për veçoritë që lidhen me këtë kremtim dhe përmendi në të shpjegime e fjalë të dobishme të cilat zgjerojnë kraharorët e besimtarëve duke ditur se Ibnul Ha'xh në këtë vepër qorton bidatet dhe risitë që nuk i arrin argumenti i sheriatit.

Në përfundim unë nuk gjej fjalë më të mirë sesa ajo e El-Busajrit, Allahu e mëshiroftë, kur thotë:

"Me trup e me shpirt u krij'u i plotë,
U zgjodh më i dashtun tek i Madhi Zot";
"Meritat që i ka, askush s'i afrohet,
Diamant' i pastër nuk mund të copëtohet";
"Përveç qenies zot, çdo lavd i përket,
S'të ngremë si të tjerët gjer n'divinjitet";
"Mandej derdh për të çdo nder e lavdi,
Atij i takon çdo lavd e madhështi";
"Nderimi për të s'njeh asnji kufi,
Lavd e tij s'përshkruhet kurrë me gojtari".

Shqipëroi nga arabishtja: Jusuf Salkurti

DOBITË E AGJËRIMIT

të Ramazanit

Muaji i Ramazanit është muaji ku Allahu i shumfishon shpërblimet për agjëruesit dhe i ngre ata në shkallët e larta të devotshmërisë. Me agjërimin e Ramazanit më së miri shprehet besimi, sinqeriteti, humaniteti, uniteti, solidariteti.. virtyte këto të cilat duhet të stolisin çdo besimtar. Me anë të agjërimit në këtë muaj, arrijmë të krijojmë jetë më të ngritur shpirtërore, një atmosferë mirëkuptimi, mirësjelljeje, devocioni, një atmosferë bujarie, ndershmërie dhe përgjegjësie, duke i pranuar gabimet dhe duke kërkuar faljen e Zotit. Profeti Muhamed (s.a.s.) thotë: "Gjumi i agjëruesit vlerësohet si adhuring, kurse heshtja si tesbih (madhërim i Zotit). Mirësive dhe adhurimeve të tij u jepet shpërblim shumëfish. Allahu ia pranon lutjet dhe ia fal mëkatet" (Kenzu'l-Umal, 3/327).

Agjërimi i muajit të Ramazanit është nga pikat e para të themeleve të besimit në fenë Islame. Ai ka disa anë të dobishme sidomos në aspektin shpirtëror, edukimit të nefsit (egos, unit), si dhe për të shprehur falënderimin ndaj Allahut (xh.sh.), për mirësitë që na ka dhënë.

Dobitë e agjërimit në planin shpirtëror

Njerëzit, nën perden e pakujdesisë të të mirave materiale, nuk arrijnë të vlerësojnë dhe të çmojnë të mirat e Allahut (xh.sh.). Zoti me urdhërin e agjërimit të Ramazanit, i shtyn besimtarët të vihen si në pozitën e një ushtrie. Ai i fton besimtarët të marrin

pjesë në një adhuring dhe festë të amshueshme. Ata dalin dhe presin ftesën e iftarit me fjalën e ezanit të akshamit, duke thënë: "Allahu-Ekber!" Përkundrajt kësaj situatë të bukur të Mëshirshmërisë së gjerë të të Gjithmëshirshmit, besimtarët përgjigjen me një rregullsi dhe përsosmëri të shkëlqyer. Të gjithë besimtarët në momentin e iftarit, përpara sofrës presin urdhërin e Krijuesit të Madhëruar.

Nefsi i njeriut nga pakujdesia e harron vetveten, sepse mban dobësinë, varfërinë e pafundme dhe paafhtësitë e panumërta. Ai nuk do që t'i shohë ato dhe ta kuptojë se është një i varfër që mund të shkojë drejt zhdukjes. Ky është edhe thelbi i fatkeqësisë, sepse ai është një krijesë që është krijuar prej mishi dhe kocke, që do të priset së shpejti dhe do të ndahet. Ai mendon se ka një trup prej çeliku, që kurrë nuk do të zhduket, prandaj sulet pas interesave të kësaj bote, duke imagjinuar se nuk do të vdesë. Me një ambicje të tmerrshme dhe me një lidhje të fortë pas kësaj bote, bën çdo përpjekje. Tërhiqet pas çdo gjëje që është e shijshme dhe e vlefshme, duke e harruar Krijuesin që e edukon me mëshirën e pasosur. Më në fund rrokulliset në moralin e keq, duke mos menduar për përfundimin e jetës, sepse edhe ai do të vdesë një ditë dhe do të ikë në jetën e përjetshme. Agjërimi i Ramazanit u tregon dobësinë mosmirënjohësve, varfërinë dhe pakujdesinë e tyre. Për shkak të urisë ata mendojnë stomakun dhe e pranojnë nevojën e

tij. Me anë të urisë së agjërimit, njeriu e kujton se sa mashtrues është trupi i tij dhe e pranon se ka nevojë për Mëshirën e Allahut (xh.sh.). Uria e shtyn të braktisë idhujtarinë e nefsit dhe të pranojë dobësinë dhe varfërinë e tij. Në këtë mënyrë i zgjohet dëshira që të mbështetet në praninë e Allahut (xh.sh.).

Dobitë e agjërimit në planin moral

Agjërimi është lartësim i shpirtit, ushtrim për përforcimin e trupit dhe nxitës për bamirësi. Ai synon ngritjen e ndërgjegjes së individit, ndriçimin e mendjes dhe zbardhjen e zemrës. Ai është një institucion edukativo-moral, i cili synon edukimin fizik e shpirtëror të njeriut ku e përgatit atë përballë sprovave me të cilat ballafaqohet në jetën e përditshme. Nëpërmjet agjërimit njeriu aftësohet për të disiplinuar dëshirat e tij dhe ka vullnet e fuqi për të kryer çdo punë me përpikmëri. Ai përsos aftësinë fizike dhe lartëson virtutet morale duke kultivuar të përshtaturit me kushtet e ndryshme social-ekonomike të jetës së përditshme. Duke agjëruar njeriu menjanon me ndërgjegje ushqimin sipas orarit të caktuar në agim dhe në përfundim të diellit, largon mendimet dhe sjelljet e pahijshme dhe shton ndjenjën e tolerancës aq të nevojshme për shoqërinë ku jetojmë, duke kontribuar kështu për harmonizimin e raporteve në familje, punë dhe shoqëri.

Devotshmëria është qëllimi i vërtetë i agjërimit dhe nëse e kuptojmë dhe e pranojmë si qëllim kryesor, atëherë më pas, do të gjejmë të gjitha frytet dhe dobitë e tij. Objektivi final i agjërimit është mirëqenia e njeriut dhe lumturia e tij në të dy botët.

Të privosh vetveten nga gjërat thelbësore të jetës, nuk është një akt i lehtë. Kjo kërkon një personalitet të fortë për të patur një vetkontroll, vetëdisiplinë dhe vetëpërmbytje. Ky program vetushtrues gjatë muajit të Ramazanit, ka rëndësi të veçantë në jetën e përditshme. Një besimtar që mund të përmbajë veten nga gjërat thelbësore të jetës për një kohë të caktuar dhe kur këtë e bën për hir të dashurisë për Allahun, meriton një shpërblim nga vetë Krijuesi. Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë: "Ka shumë njerëz që agjërojnë, e nga kjo nuk kanë asgjë, përveç urisë dhe etjes. Ka shumë njerëz që luten natën, e asgjë nuk ka nga kjo lutje, përveç pagjumësisë, i këthillë është çdo njeri, i cili nuk e kryen këtë veprim me besnikëri dhe sinqeritet të plotë" (Ibn Maxhe, Sijam, 21).

Dobitë e agjërimit në planin shëndetësor

Çdo makinë, pas një kohe të caktuar funksionimi, ndalohet për t'iu bërë mirëmbajtja e nevojshme. Po nuk u bë kjo, ose makina shkatërrohet plotësisht, ose i shkurtrohet jetëgjatësia. Pas një periudhe mësimi, nxënësit i jepet pushim. Një punëtor punon nga mëngjesi në mbrëmje, por në mbrëmje tërhiqet për pushim. Pa këto pushime dhe rimbledhje forcash, është e pamundur të punohet me të njëjtin ritëm e të jepet prodhim. Trupi i njeriut është si një fabrikë, kurse gjymtyrët e tij si makineritë e asaj

fabrike. Agjërimi është pretekst që trupi ynë të pushojë, të mos vjetërohet shpejt, por të vazhdojë të punojë në mënyrën më të mirë.

Shkenca është në gjendje të evolucionit të vazhdueshëm dhe zbulimeve që ndjekin njëra tjetrën. Studime të shumta janë bërë kohët e fundit në lidhje me dobitë shëndetësore të agjërimit. Agjërimi Islam, që relativisht është më rigoroz dhe më i gjatë se në fetë e tjera, është objekt diskutimesh dhe studimesh në mjaft konferenca botërore të mjekësisë së sotme. Sot, kur të gjitha shkencat kanë përparuar dukshëm, ndër to edhe mjekësia, vlera e agjërimit është edhe më e evidente, e cila është konfirmuar më së mirë edhe shkencërisht. Ky vlerësim gjen vetveten në hadithin e profetit Muhamed (a.s.) ku thotë: "Agjëroni, që të jeni të shëndetshëm" (Mundhiri, et-Terhib, 2/206).

Sot në vendet e zhvilluara, ekzistojnë institucione të specializuara, ku merren me studimin e dobive të agjërimit duke konkluduar se gjatë Ramazanit trupi pastrohet nga helmët që gjenden në të, pa prodhuar helme të reja. Kështu, mjeku i njohur Reidlin nga studim i tij që i bëri njerëzve me agjërim, pohoi që agjërimi është një operim pa bisturi. Sa më shumë që përparon shkenca e mjekësisë aq më të shpeshta dhe të shumta janë të dhënat mbi vlerën e madhe të agjërimit në aspektin mjekësor. Nuk është çështje e panjohur si në Zvicër, Angli, Gjermani dhe Francë, që ekzistojnë klinikat të specializuara ku shërbimi i të sëmurëve me sëmundje të ndryshme bëhet ekskluzivisht me trajtim të agjërimit. Shkencëtari me famë botërore që ka fituar çmimin Nobel në vitin 1940, Alexis Carrel, në librin e tij "Njeriu, Ky i Panjohur" (L'Homme, Cet Inconnu), thotë: "Gjatë agjërimit ushqimet e depozituara në organizëm konsumohen, më pas zëvendësohen me të reja dhe në këtë mënyrë në të gjithë trupin ndodh një rinovim, gjë i cili vërteton se agjërimi është i dobishëm për trupin. Në aspektin shëndetësor agjërimi prezanton fuqinë e trupit kundër sëmundjeve. Mbas rezultateve tashmë të njohura, nuk na befason fakti që shumë mendje të mëdha njëkohësisht kanë qenë edhe aderues të mëdhenj të agjërimit. Kështu, Vinston Çerçill në moshë të thellë shpesh herë praktikonte agjërimin 24 – 48 orësh, duke dëshmuar se agjërimi është mënyra më e mirë që të arrihet koncentrimi i plotë i mendimeve. Mjeku amerikan Shelton, luftëtar i madh i agjërimit, e preferonte përmbajtjen nga ushqimet për qëllime shëruuese në kohëzgjatjeje prej tre javësh.

Gjatë agjërimit sistemi nervor është në një qetësi absolute. Kënaqësia që na jep kryerja e një adhurimi, i shuan të gjitha tensionet dhe pakënaqësitë tona. Në këtë mënyrë, shmangen streset, të cilat janë ndër problemet më të mëdha të ditëve të sotme. Kështu, agjërimi është edhe shpëtim për këto sëmundje, edhe pretekst i rëndësishëm për të fituar mirësi e shpërblim.

**Shkëputur nga libri 'Ilmihal i zgjeruar'
Botim i tre komuniteteve fetare.
Tiranë – Prishtinë – Shkup, 2018.**

Ibn Haldun

MBI LUKSIN DHE SHKATËRRIMIN E QYTETËRIMEVE

Ish Presidenti i Sh.B.A. Ronald Reagan iu referua me krenari citatit të mësipërm të Ibn Haldunit në një artikull për International Herald Tribune në 1993 me titull: "Më falni Z. Clinton, me siguri ju kam dëgjuar keq" (21 Shkurt 1993, f. 4). Reagan nuk e citoi Ibn Haldunin herën e parë në 1993. Në të vërtetë ai e citoi atë shumë vite më herët, në fillim të mandatit të tij në Shtëpinë e Bardhë, si një mbështetje për politikën e tij të ekonomisë, të ashtuquajtur Reaganomics. Megjithatë, disa historianë [1] nuk panë asnjë lidhje midis Reaganomics dhe teorive të Ibn Haldunit, Reagan tërhoqi vëmendjen e njerëzve duke iu referuar këtij studiuesi të shquar, por kryesisht të harruar (të paktën në Perëndim). Emri ishte i huaj për shumë veshë dhe për shumë

amerikanë, ishte hera e parë që kishin dëgjuar për të.

Kush ishte me të vërtetë Ibn Halduni? A ishte ai ekonomist? Sipas shumë llogarive, ai doli me shumë koncepte ekonomike 400 vjet para Adam Smith. Ibn Haldun ishte frymëzimi pas konceptit të njohur gjerësisht si "Lakorja e Laffer". Sidoqoftë, ai nuk ishte ekonomist, në vetvete.

A ishte ai historian? Historiani i famshëm Arnold Toynbee deklaroi se libri i Ibn Haldunit, Mukaddimeh, është libri më i madh në llojin e tij. Por akoma të tjerët pretendojnë se ai ishte kryesisht një filozof dhe një shkencëtar politik.

Sot, konsensusi midis studiuesve është që Ibn Halduni i përfshinte të gjitha, megjithatë sot, ai është i njohur kryesisht për të qenë themeluesi i

sociologjisë. Në fakt, vetë rrëfimet e Ibn Haldunit e vërtetojnë këtë pikëpamje. Në librin e tij thelbësor, Mukaddimah, shpesh i përkthyer si "Prolegomenon", ai deklaroi se kishte krijuar një shkencë të re. Me fjalët e tij:

"duhet të dihet që diskutimi i kësaj teme është diçka e re, e jashtëzakonshme dhe shumë e dobishme. hulumtimi depërtues ka treguar rrugën drejt tij." (BAALI 1988)

Ky artikull është një admirim për Ibn Haldunin, dijetarin e madh musliman të shekullit të katërmëdhjetë. Ai prezanton shkurtimisht jetën e tij dhe perspektivën sociologjike të kontributeve të tij, veçanërisht idetë e tij mbi luksin dhe ndikimin e tij në dobësimin e asabijjes, ose solidaritetin në grup. Ky është një

nga konceptet më të rëndësishme në shkrimet e tij dhe konsiderohet si fara e teorisë së tij të famshme ciklike të ngritjes dhe rënies së kombeve.

Ibn Halduni

Abd el-Rrahman ibn Muhamed, i njohur përgjithësisht si Ibn Haldun (emri erdhi nga një paraardhës i largët), lindi në Tunis (Afrika e Veriut) më 27 maj, 1332, në një familje të klasës së lartë që kishin ikur nga Sevija, në 1248, për t'i shpëtuar pushtimit të krishterë të Andaluzisë. Familja e tij kishte dëshmuar ngritjen dhe rënien e pushtetit musliman në Spanjën e Jugut.

Si një fëmijë i privilegjuar, Ibn Haldun kishte një arsimim të plotë në fizikën dhe filozofinë aristoteliane, si dhe matematikë, fe, gjeografi dhe poezi. Mësuesit e tij ishin studiues të shquar të kohës së tyre. Në shekullin e katërmëdhjetë, në një epokë trazirash dhe paqëndrueshmërie politike, ai filloi transportuesin e tij si një bartës i vulave dhe më pas u bë një zyrtar politik. Ai punoi si burrë shteti, ambasador dhe jurist në qytete nga Fezi deri në Granada.

Në 1375, duke u lodhur nga politika e kohës së tij, Ibn Khaldun u mbyll në fortesën Salama, afër Konstandinit, për katër vjet. Nga ky izolim, ai doli pasi kishte shkruar një nga studimet më të mëdha mbi historinë, veprën e tij madhështore, Mukaddimeh: Një Hyrje në Histori.

Duke u mbështetur në përvojat e tij personale dhe historinë rajonale të Afrikës Veriore, ai identifikoi një model ciklik të ngritjes dhe rënies së civilizimeve dhe më pas ai analizoi faktorët që kontribuojnë në modele të tilla. Ai studioi dinamikën e marrëdhënieve në grup dhe argumentoi atë asabijeh, ose solidariteti në grup, është jetik për fuqinë politike dhe për ngritjen e një civilizimi të ri. Ai pohoi se stilet e jetës së ulur të



jetës urbane të qytetit futin zakone luksoze në jetën e njerëzve, duke shkaktuar kështu gradualisht një përkeqësim të asabijes dhe krijimin e kushteve për kolapsin civilizues. Sipas Ibn Haldun, një sundimtar veçanërisht i fortë mund ta vonojë këtë shkatërrim; megjithatë, asabijah do të prishet - përgjithësisht brenda pesë brezave - pasi ngjarjet në mënyrë të natyrshme ndjekin një proces ciklik. Çdo komb përmban brenda vetes farën e shkatërrimit të vet.

Duke pasur një sy të mprehtë për sjelljen njerëzore dhe një aftësi të rrallë për të organizuar vëzhgimet e tij, Ibn Haldun ndryshoi historinë thjesht duke regjistruar ngjarje dhe duke treguar histori të cilat mund të shpjegojnë dhe parashikojnë sjelljen njerëzore. Metodën e tij u rritën nga besimi i tij se kërkimi shkencor kërkon: (1) vëzhgime të sakta; (2) metoda logjike dhe objektive; (3) mbledhjen e të dhënave nga e tashmja dhe e kaluara; (4) regjistrim të kujdesshëm; dhe (5) guximin e përshkrimit dhe raportimit të kujdesshëm (Faghizadeh 1982). Ndryshe nga shumica e shkrimtarëve para tij, ai theksoi faktorët shoqërorë, ekonomikë, psikologjikë dhe mjedisorë që qeverisnin ngjarjet. Kjo qasje revolucionare hodhi bazat për një shkencë të re: 'Ilm Umran (Shkenca e shoqërisë), siç e quante Ibn Haldun në Mukaddimeh. Duke shpjeguar faktorët shoqërorë pothuajse pesë shekuj para mendimtarëve klasikë socialë të shekullit XIX si Comte, Marks, Durkheim dhe Weber, ai konsiderohet pararendësi i sociologjisë. Dhe njohuritë dhe vëzhgimet e tij të thella për shoqërinë në të cilën ai jetoi ende frymëzojnë studimet sociologjike të kohërave tona.

Pasi kishte shkruar librin e tij, Ibn Haldun u lodh nga veçimi, shkoi në Kajro dhe miratoi një rol mësimdhënës në Universitetin Al-Azhar. Reputacioni i tij i kishte paraprirë atje: Al-Azhar ishte i mbushur me studentë dhe shumë studiues të shquar që vinin për të dëgjuar teoritë e tij mbi fenomenet shoqërore. Ndërsa ishte në Kajro, ai mësoi lajmin shkatërrues se e gjithë familja e tij ishte humbur në një anije ndërsa po vinin nga Tunisi për t'u bashkuar me të. Me përjashtim të pelegrinazhit të tij në Mekë në 1387, dhe disa udhëtimeve në Damask, ai qëndroi në Kajro për pjesën e mbetur të jetës së tij, duke shërbyer si kryeprokuror. Ai vdiq në 1406 në moshën shtatëdhjetë

e katër, menjëherë pas emërimit të tij të gjashtë për gjyqësor.

Ai vazhdoi të shkruajë deri në fund të jetës së tij. Krahës Mukaddimes, vëllimet e tjera në Kitab'l-Ibar, libri i tij mbi historinë botërore, trajtuan historinë e arabëve, persëve, evropianëve, romakëve, hebrenjve dhe grekëve. Në vëllimin e fundit të librit të tij, ai nisi një traditë të re duke shkruar një autobiografi analitike, të njohur si El-Tasrif.

Gjatë dy shekujve të fundit, pas përkthimit të parë të plotë frëngjisht të Mukaddimes nga de Slane në 1863, Ibn Halduni është zbuluar nga studiuesit në Perëndim dhe është njohur si një nga mendimtarët e mëdhenj të botës muslimane. Megjithatë, ishte përkthimi i parë në anglisht i Franz Rosenthal në 1958 që lejoi Mukaddimen të arrinte vlerësimin më të madh në Shtetet e Bashkuara dhe jashtë saj.

Asabijah dhe modeli ciklik

Le të shohim më afër asabijën. Rrjedhur nga rrënja arabe asab (për të lidhur), koncepti i asabijes është një nga konceptet më domethënëse në shkrimet e Ibn Haldun. Megjithëse disa sugjerojnë mbajtjen e termit arab, sepse nuk mund të përkthehet në mënyrë adekuate, përkthimi anglisht "solidariteti i grupit" i afrohet kuptimit termit origjinal. Asabijah, në terminologjinë khaldunian, pra, është një lidhje shoqërore e kohezionit që përdoret për të matur stabilitetin dhe forcën e grupeve shoqërore. Solidariteti midis anëtarëve të grupit është kryesisht për shkak të bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe ndërvlerësimit të anëtarëve të tij. Në këtë aspekt, identiteti i një individi bashkohet në grupin ku ai ose ajo është anëtar, dhe kështu ata bëhen "një nga të tjerët" (Ibn Haldun 1967, 277).

Sipas Ibn Haldunit, kjo lidhje, asabijeh, është faktori më i rëndësishëm në zhvillimin e një shoqërie apo civilizimi nga një fis nomad në një shtet. Ai argumentoi se asabijeh është më e forta në fazën nomade dhe zvogëlohet ndërsa përparon një civilizim. Koncepti i asabijat-it përshtatet në skemën e tij të përgjithshme të procesit ciklik dhe ngritjes dhe rënies së civilizimeve.

Nga këndvështrimi i tij, çdo cikël ka 5 faza: 1) pushtimi; 2) ngritja; 3) toleranca; 4) tirania; dhe 5) dekadencia (rënia). Me fjalë të tjera, çdo shoqëri krijohet, i afrohet përsosmërisë, bie dhe zëvendësohet nga një shoqëri tjetër.

Është një ndjenjë e fortë e asabijjes që çon në pushtim, pastaj në jetën e ulur urbane; së fundmi, është një shije për luks që çon në kolaps shoqëror. Kështu, nomadët, të cilët dikur kishin një solidaritet të fortë mes tyre dhe ishin të njohur për trimërinë dhe punën e tyre bëhen më pak të guximshëm, më pak të zellshëm dhe shumë më individualistë në qytetet urbane nën ndikimin e zakoneve luksoze. Ibn Halduni përmbledhi të gjithë procesin si më poshtë në Mukaddimah :

“Si rezultat, qëndrueshmëria e jetës në shkretëtirë humbet. Ndjenja dhe guximi në grup dobësohen. Anëtarët e fisit kënaqen me mirëqenien që Zoti u ka dhënë. Fëmijët dhe pasardhësit e tyre rriten shumë krenarë për t’u kujdesur për veten e tyre ose për t’u kujdesur për nevojat e tyre. Ata kanë përbuzje edhe për të gjitha gjërat e tjera që janë të nevojshme në lidhje me ndjenjën në grup Ndjenja dhe guximi i tyre në grup zvogëlohen në gjeneratat e ardhshme. Përfundimisht ndjenja e grupit shkatërrohet tërësisht. ... Do të përpohet nga kombet e tjera.” (Ibn Khaldun 1967, 107)

Ibn Haldun vuri theksin te fuqia e fesë për ta mbajtur të fortë asabijjen në një shoqëri. Sipas tij, feja nuk është thjesht një tërësi ligjesh morale, por përcakton të gjitha marrëdhëniet në një shoqëri. Ai pohoi se nëse devotshmëria zëvendësohet nga ambicia, dhe nëse kjo e fundit merr përsipër sjelljen njerëzore në një shoqëri, atëherë dëshira tradhtarë për të fituar pasuri do të përshkojë zemrat e njerëzve. Kjo do ta bëjë një shoqëri dhe njerëzit e saj tekanjozë, pra korrupsioni dhe rënia eventuale. Si shembull, ai vuri në dukje kohën e Harun err-Rashid, dhe se si pasi ajo kaloi, kërkimi i kënaqësisë dhe korrupsioni shkatërruan asabijjen e fortë të civilizimit të hershëm islamik. Ata kishin braktisur rrugën e devotshmërisë.

Luksi dhe procesi ciklik

Luksi përbënte një temë themelore në sociologjinë e Ibn Khaldun, sepse për të ishte faktori kryesor që dallonte jetën e qytetit urban nga jeta nomade. Ai pohoi se luksu në qytete ndjek disa faktorë ekonomikë. Në qytete, puna e tepërt është në dispozicion për të prodhuar luks; kështu, njerëzit e qytetit kanë të ardhura më të larta sesa njerëzit në zonat rurale, dhe kjo çon në standarde më të larta të jetesës në shtëpi, veshje, etj.

Megjithëse një mënyrë jetese luksoze fillimisht shkakton prosperitet në qytet dhe shton forcën e civilizimit, Ibn Halduni argumentoi se zakone të tilla luksoze përfundimisht bëhen pengesa. Ato krijojnë shumë kërkesa dhe imponojnë aq shumë nevoja sa individit nuk mund të fitojë aq sa t’i kënaqë ato. Për më tepër, si rezultat i taksave shtesë të vendosura nga qeveria për mallra të tillë, çmimi i mallrave të ndryshëm rritet, dhe kjo nga ana e tij kontribuon në koston e jetesës, e cila për pasojë redukton shumicën e njerëzve në qytet në varfëri. Kështu, luksu rrit shpenzimet e njerëzve dhe të shtetit dhe çon, sipas Ibn Haldun, në falimentimin e shtetit.

Ibn Khaldun argumentoi se luksu jo vetëm që dobëson shtetin ekonomikisht, por gjithashtu shkakton disavantazhe të tjera fizike, morale, sociale dhe politike. Fizikisht, kjo i bën njerëzit të dobët dhe më pak të imunizuar ndaj sëmundjeve, veçanërisht “kur një thatësi ose uri i godet” (Ibn Haldun 1967, 177-182). Moralisht, luksu është shkatërrues në kuptimin që bind njerëzit të vlerësojnë komoditetin material mbi të gjitha dhe të preferojnë interesat e tyre individualë sesa interesat e të tjerëve. Praktikisht luksoze bëhen të domosdoshme. Dëshira dhe marrja e luksit përfundimisht rezulton në një degradim të shpirtit dhe lind pandershmëri dhe sjellje të tjera imorale.

Për më tepër, ajo gjithashtu shkatërron asabijjen në grup pasi që ndjekja e rehatisë materiale bëhet qëllim i thelbësor i shumicës së individëve. Si rezultat i shpërbërjes së ndjenjës së grupit, grupi bëhet pre e lehtë për pushtuesin tjetër. Drejtuesit e shtetit bëhen gjithnjë e më të dobët dhe më pak të disiplinuar, ndërsa gjithashtu shqetësohen më shumë për ruajtjen e fuqisë dhe mënyrës së tyre të jetesës. Lidhjet e tyre me grupin periferik lirohen, dhe asabijah kthehet në individualizëm dhe fraksionizëm, dhe kështu fuqia e tyre politike zvogëlohet. Në këto kushte, ato janë të ndjeshme ndaj shpërbërjes politike, veçanërisht nga grupet në periferi. Kështu, kushtet për një pushtues të ri janë gati dhe cikli fillon përsëri. Përmes këtij modeli të periferisë qendrore, Ibn Halduni shpjegoi se si secili civilizim ka brenda vetes farën e rënies së vet.

Përshtati nga anglishtja Haki Sahitaj

KUSH LIROHET NGA *Agjërimi*

Rastet kur njeriu lirohet nga agjërimi:

- Sëmundja është një prej atyre rasteve, kur njeriu lirohet nga agjërimi, nëse ajo e dëmton agjëruenin e sëmurë ose ia vonon shërimin, kështu që me këshillim të mjekut specialist të fushës dhe të përkushtuar në fe, ai lirohet nga agjërimi, kushtimisht që ditët që ka prishur t'i kompensojë (kaza) më vonë, kur të shërohet.

- Udhëtimi - I njëjtë si me rastin e sëmundjes është edhe rasti i udhëtarit, për shkak të vështirësive që paraqet udhëtimi. Pra, në qoftë se një person është i detyruar të udhëtojë duke agjëruar, dhe kjo për të paraqet vështirësi të jashtëzakonshme, ai nuk duhet të agjërojë, sepse kjo mund ta shpjerë në rrezik jete.

Udhëtimi i ligjshëm që e justifikon mosagjërimin është ai që i shkakton mundime e vështirësi personit, që e ka bërë nijet të arrijë në një vend, largësia e të cilit është 90 km e më tepër dhe i cili ka vendosur që atje të qëndrojë më pak se 15 ditë. Mirëpo, në qoftë se agjërimi nuk e dëmton ose nuk i paraqet vështirësi ose shqetësime, ai mund edhe të agjërojë. Edhe nga kjo dispozitë sheriatike vetëkuptohet se Ligjdhënësi - Allahu xh.sh., nuk i ngarkon njerëzit me përgjegjësi që nuk mund t'i mbajnë, prandaj edhe urdhrat janë në masë të pranueshme. Ditët e paagjëruara

gjithsesi duhen agjëruar më vonë kaza. Allahu xh.sh. ka thënë në Kur'an:

“E kush është i sëmurë ose në udhëtim, (le të agjërojë) aq (ditë) nga ditët e tjera.” (Bekare, 184)

- Të përmuajshmet e grave dhe lehonja: Gjatë kohës kur femra është me të përmuajshmet e veta ose në kohën e lehonisë, jo vetëm që lirohet, por madje nuk i lejohet të agjërojë dhe as të falë namaz. Në qoftë se kjo gjendje ka ndodhur në ditët gjatë Ramazanit, atëherë ato ditë duhet t'i kompensojë pas Ramazanit në një kohë të përshtatshme, kurse namazin nuk ka nevojë ta plotësojë. Kjo bazohet në një rrëfim të Muadhrit, i cili kur e kishte pyetur hz. Aishen se pse femra me menstruacione e bën kaza - kompenzon agjërimin e jo edhe namazin, ajo i kishte thënë: “Kur ishim bashkë me të Dërguarin e Allahut, kur unë isha me të përmuajshme, më thoshte ta bëja kaza vetëm agjërimin, kurse për namazin nuk më pati thënë gjë.” (Transmetojnë Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ahmed b. Hanbeli). Hazreti Aishja me një rast tjetër ka thënë: “Kur ne gratë e familjes së Profetit ishim me zakonet e grave (të përmuajshmet) ose lehoni, Profeti na urdhëronte të mos agjëronim dhe të mos e falnim namazin, e pas pastrimit prej tyre, na urdhëronte ta bënim kaza agjërimin e jo edhe namazin.” Kjo për shkak të numrit të madh të namazeve të mbetura, sa kohë që gruaja është e angazhuar me fëmijët, burrin dhe shtëpinë e saj, dhe po që se ajo detyrohet me kazanë e namazeve, kjo do ishte një barrë e madhe për të, ndryshe nga agjërimi, i cili është një herë në vit, kështu që kazaja e tij nuk është edhe aq e vështirë.

- Shtatzënësia dhe ushqimi me gji (mëkimi). Gratë shtatzëna dhe ato që janë mëkuese, me qëllim që të mos dëmtohen vetë, si dhe fëmijët e tyre, përfitojnë nga leja për të mos agjëruar. Mirëpo, ditët e paagjëruara duhet t'i plotësojnë pas përfundimit të mëkimit.

- Pleqëria. Nëse njeriu është i moshuar dhe nuk mund ta përballojë dot agjërimin, ose e përballon por me shumë shqetësime e vështirësi, atij i lejohet mosagjërimi.

Në realitet, ata do të duhej që së paku tri ditë të fillojnë të agjërojnë dhe të binden se nuk mund ta përballojnë, madje as në stinën e dimrit, kur dita është dukshëm më e shkurtër. E pra, pasi vërtetohet se ata nuk kanë mundësi as ta bëjnë detyrimin kaza, atëherë detyrohen me shpërblësë (të ushqejnë një të varfër, ushqim njëditor me dy vakte dhe me masë të caktuar) që i jepet një të varfri për çdo ditë të cilën nuk e ka agjëruar. Allahu xh.sh. me Kur'an na ka urdhëruar:

“E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim njëditor një të varfri...” (Bekare, 184).

Ndërkaq, nëse ai vetë është i varfër dhe nuk ka mundësi për shpërblësë (fidje), atëherë nuk ka kurrfarë detyrimi.

Ibn Abasi lidhur me ajetin e sipërshënuar ka thënë: “Ky ajet nuk është i anuluar (mensuh), por ka të bëjë me plakun dhe plakën që nuk kanë mundësi të agjërojnë, të cilët, për çdo ditë, si shpërblësë, duhet të ushqejnë nga një të varfër. Ky ajet, njëkohësisht, ka të bëjë edhe me të sëmurin nga një sëmundje për shërimin e së cilës nuk ka shpresë...”.

Ikrimah bin Ammari ka treguar një rast të tillë: “Një herë e pyeta Tavusin lidhur me nënën time, e cila kishte një sëmundje për shkak të së cilës ajo pinte ujë shumë shpesh e nuk mund ta shuante etjen (diabetike), kështu që nuk kishte mundësi të agjëronte Ramazanin. Ai më tha: - Le të ushqejë për çdo ditë nga një të varfër me nga dy mudde (njësi matjeje ushqimi). I thashë: - Me çfarë mudde? Ai më tha: - Me atë të vendit tënd.” (Rastin e ka regjistruar Abdurrezaku).

Pra, këtu duhet pasur kujdes se nga agjërimi lirohet plaku ose plaka të shtyrë në moshë, për shkak të pleqërisë dhe i sëmurë pa shpresë për shërim. Mirëpo, në qoftë se i sëmurë nuk ka agjëruar dhe në fund të Ramazanit e ka paguar shpërblësën (fidjen) e pas një kohe është shëruar, ai duhet që ditët që nuk i ka agjëruar t'i bëjë kaza, sepse i është krijuar mundësia për agjërim.

- Ballafaqimi me armikun në luftë. Në qoftë se agjërimi e dobëson agjëruesin, i cili duhet të ballafaqohet

në fushëbetejë me armikun, atëherë atij i lejohet të mos agjërojë. Kjo për faktin se interesi i përgjithshëm ka përparësi ndaj atij individual dhe se këtë të dytin mund ta realizojë edhe më vonë. Ditët e paagjëruara duhet të bëhen kaza.

- Prishja e agjërimit për shkak të presionit-dhunës fizike. Nëse agjëruesi kërcënohet me jetë ose lëndim të rëndë trupor ose këputje gjymtyre nëse nuk e prish agjërimin (kur e ka të detyrueshëm-farz), atij i lejohet edhe ta prishë e më pas duhet bërë kaza.

- Puna e rëndë fizike. Ka punëtorë të cilët janë të detyruar të kryejnë punë të rënda fizike, ose të rrezikshme për jetën, siç është puna në miniera, në metalurgji, ose në termocentrale, sidomos ditëve të gjata e të nxehta të verës. Të tillët duhet ta provojnë agjërimin, por nëse nuk kanë mundësi për ta përballuar, ose kanë frikë se do t'u rrezikohet jeta, atëherë iu lejohet mosagjërimi dhe ditët e paagjëruara duhet t'i bëjnë kaza gjatë ditëve të pushimit ose dimrit, kur janë ditët më të shkurtra. Andaj, ata nuk kanë nevojë të rrezikojnë jetën e tyre e as ta ndërpresin punën për shkak të pamundësisë për të agjëruar, ngase nga të ardhurat e tyre personale varet mirëqenia materiale e familjes së tyre.

Kazaja e ditëve të prishura nuk është kusht të bëhet pa ndërprerje dhe, nga ana tjetër, kur njeriut i ofrohet mundësia duhen përmbushur sa më parë, e jo t'i vonojë pa nevojë. Borxhi ndaj Zotit duhet të paguhet sa më shpejt që është e mundur. Agjërimi i ditëve të paagjëruara mund të bëhet edhe me ndërprerje të tyre. Transmetohet nga Ibni Omeri r.a. sesi Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Kompensimin (kazanë) e Ramazanit nëse dëshiron e agjëron ndaras, e nëse dëshiron i bashkon”. (Darekutni)

Ngjashëm transmeton edhe Buhariu sesi Ibn Abasi kishte thënë: “Nuk prish punë nëse kompensimi i Ramazanit bëhet me ndërprerje.”

**Shkëputur nga libri 'Ilmihal i zgjeruar'
Botim i tre komuniteteve fetare.
Tiranë – Prishtinë – Shkup, 2018.**

REKOMANDIMET GJATË AGJËRIMIT TË RAMAZANIT TEK DIABETIKËT

Allahu i Madhërishëm në Kuranin famëmadh urdhëron e thotë:

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.

(Jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri, ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për te. Mirëpo, po qe se e dini, agjërimi është më i mirë për ju. (Ato ditë të

numëruara janë) Muaji i Ramazanit që në te (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtër). E kush e përjeton prej jush këtë muaj le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju. (Të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) Që të plotësoni numrin, ta madhëroni Allahun për atë se u udhëzoi dhe që të falënderoni”.

Mjekët e sotëm që fare pak e njohin Islamin, e sidomos rëndësinë e agjëritit të muajit të

Ramazanit, në mënyrë kategorike ua ndalojnë agjërimin të sëmurëve me diabet që në vizitën e parë. Mungesa e literaturës adekuate për këtë subjekt e bën edhe më të vështirë përgjigjen në këtë çështje.

Objektivi i kësaj trajtëse është që të njoftohen mjekët të cilët ballafaqohen me pikat e vështira të këshillave për pacientët diabetik në lidhje me sigurinë e agjëritit gjatë muajit të Ramazanit. Janë gjetur të dhëna të ndryshme në lidhje me efektin fiziologjik të Ramazanit në diabetikët.

Sidoqoftë, kërkimet nuk kanë gjetur ndryshime patologjike ose komplikime klinike në secilën

prej parametrave të mëtejme në diabetikët të cilët agjërojnë; pesha trupore, glukozë në gjak, HbA1C, c-peptidet, insulina, fruktosamina, kolesterolit dhe trigliceridet. Në seksionin revistor të këtyre trajtesave ne i rekomandojmë pacientët diabetik në mënyrë të sforcuar që të mbajnë aktivitetin e rregullt ditor dhe regjimin e dietës.

Është gjithashtu vendimtare që diabetikët të adaptojnë trajtimin e tyre me medikamente, kryesisht ata pacient të diagnostifikuar si Insulin varës (IDDM). Ne i kemi emëruar këta 3 faktorë kryesorë –v përshtatshmëria e regjimit me medikamente, kontrolli i dietës dhe aktiviteti ditor –;

Ramazani 3D trekëndësh

Me vërejtjen e 3D, edukimi i duhur dhe udhëheqja diabetike, ne konkluduar se shumë prej pacientëve me insulin jo varës me diabetes mellitus (NIDDM) dhe pacientët e rastit me Insulin vares D.Mellitus (IDDM) të cilët insistojnë në agjërim mund ta vëzhgojnë me kujdes Ramazanin.

Për të gjykuar drejtë duke iu përmbytur etikës mjekësore të pacientëve diabetik që agjërojnë, është esenciale që mjekët të kenë njohuri për efektin e agjërit të Ramazanit në patofiziologjinë e Diabetes Mellitusit.

Në këtë artikull ne së pari

duhet të pasqyrojmë principet e metabolizmit të karbohidrateve dhe alterimeve për ndryshime biokimike të sigurta të diabetikëve që e mbajnë agjërimin.

Ne pastaj pasqyruam rekomandimin mjekësor të fundit i cili lejon agjërimin e pacientëve diabetik të besueshëm dhe planifikimin e pacientëve diabetik kryesisht IDDM (insulin varës) që nuk duhet të agjërojnë por insistojnë në agjërim.

Gjendja psikologjike e pacientëve me diabet gjatë Ramazanit:

Metabolizmi i karbohidrateve gjatë agjërit të Ramazanit në personat e shëndoshë.

Efekti i agjërit eksperimentues për një kohë të shkurtër në metabolizmin e karbohidrateve ka qenë i studiuar mjaft. Është gjetur në mënyrë uniforme një zvogëlim të lehtë të glukozës në serum prej 3.3mmol deri në 3.9 mmol (60 mg/dl deri në 70mg/dl) e cila ndodh te adultët normal disa ore pas fillimit të agjërit. Sidoqoftë, reduktimi në serum i glukozës ndodh për shkak të ngritjes së glikoneogjenezës në mëlçi. Kjo ndodh për shkak të zvogëlimit të koncentrimin të Insulinës dhe e rritjes së glukagonit dhe aktivitetit simpatik(3).

Te fëmijët e moshës 1-9 vjet agjërimi për periodën 24 orësh ka shkaktuar një zvogëlim të

glukozës në gjak te gjysma e fëmijëve normal të moshës së njëjtë. Në 22% e këtyre fëmijëve glukozë në gjak ka rënë pak se 40mg/dl(4).Disa studime kanë treguar efektin e agjërit të Ramazanit në glukozën e serumit.

Një studim ka treguar një zvogëlim të lehtë të glukozës në serum në ditën e parë të Ramazanit, e cila është normalizuar në ditën e 20 dhe një ngritje e lehtë në ditën e 29 të Ramazanit.

Niveli më i ulët i glukozës në serum në këtë studim është 63mg/dl. Të tjerat kanë shënuar një ngritje mesatare ose variacione në koncentrimin e glukozës në serum. Por të gjitha kanë rënë brenda kufijve fiziologjik.

Disa studime të mëparshme mund të supozojnë se rezervat e glikogjenit së bashku me procesin e glikoneogjenezës, i mbajnë kufijtë normal të glukozës në serum deri në përcjellje të ushqimit para agimit (sehurin). Sidoqoftë, ndryshime të lehta të glukozës mund të ndodhin në serum në mënyrë individuale në varësi nga format e ushqimit (zakonet e të ushqyerit) dhe nga ndryshimet individuale të metabolizmit dhe rregullimit të energjisë. Në vijim po sjellim një tabelë në lidhje me efektin e agjërit të Ramazanit në parametrat e ndryshëm biokimik të gjakut.

Parametrat	Dita e parë e Ramazanit	Dita e 26 e Ramazanit
Pesha e trupit ,Kg	51.9+_ 3.5*	52.6+_ 4.0
Glukoza ,mg/dl	84.1+_9.8	82.3+_82.3+_10.7
Urea,mg/dl	21.8+_7.7*	49.8+_19.1
Ac.uric,mg/dl	3.0+_0.5	31+_0.4
Proteinat,(totale)g/dl	7.8+_0.7	7.2+_0.7
Albuminat,g/dl	4.9+_0.7	4.6+_0.5
Kolesterolit(t),mg/dl	192+_0.7	180+_32
HDL-Koles,mg/dl	46+_12	43+_10
LDL-Koles,mg/dl	130+_23	91+_28
Trigliceridet,mg/dl	80.5+_38.5*	92.5+_34.7

Praktikumi i Biokimisë Klinike i Varley*

Devijimi standard

Diferenca sinjifikante ndërmjet 2 p<0.05

Pesha e trupit gjatë agjërimit të Ramazanit

(a) Në subjektet normale

Humbja e peshës prej 1.7 kg, 1.8 kg, 2.0 kg dhe 3.8 kg. Është raportuar të individët me peshë normale pasi që kanë agjëruar muajin e Ramazanit. Në një studim që është raportuar nga femrat e prezantuara nuk është vërejtur asnjë ndryshim në peshën e trupit. Është raportuar gjithashtu se personat me peshë të shtuar humbin më pak peshë se subjektet normale dhe ata me nën peshë.

(b) Te diabetikët:

Pasqyra e literaturës bashkëkohore tregon anasjelltas me ndryshimin në peshë te diabetikët gjatë Ramazanit.

Në një grup të studimeve, pacientët kanë pasur një ngritje në peshën e tyre. Në një grup, aty nuk kishte ndryshime në peshën trupore. Deri sa asnjë ushqim dhe pije nuk konsumohet prej agimit deri në përfundim gjatë muajit të Ramazanit, nuk ka reduktim në vlerën ose tipin e ushqimit të konsumuar gjatë natës. Mirëpo, shumë diabetikë reduktojnë aktivitetet e tyre trupore gjatë kësaj periode në frikë ndaj hipoglikemis. Këta faktorë mund të rezultojnë jo vetëm në moshumbje të peshës trupore por gjithashtu edhe në peshë të shtuar te këta paciente. (Shiko me tutje diskutimin për nutricionin dhe aktivitetin fizik).

Variacionet e glukozës në gjak gjatë agjërimit të Ramazanit te diabetikët

Shumë paciente nuk treguan ndryshim sinjifikant në kontrollën e glukozës. Te disa pacientë, koncentrimi i glukozës në serum mund të bie ose ngritet. Ky variacion mund të jetë i duhur për vlerat ose tipin e ushqimit të harxhuar, marrja e medikamenteve në mënyrë të rregullt, gjellitja pasi që agjërimi është prishur ose zvogëlimi i

aktivitetit fizik. Në shumë raste, asnjë episod i komplikimeve akute (tipi hipoglikemik ose hiperglikemik) nuk ndodh nën kontrollën mjekësore dhe vetëm disa raste të hipoglikemise biokimike pa rrezik klinik janë raportuar.

Parametra tjerë të kontrollës së diabetit gjatë agjërimit të Ramazanit

Në përgjithësi, vlerat e HbA1C nuk kanë treguar ndryshime ose përmirësime gjatë muajit të ramazanit. Vetëm 2 studime kanë raportuar në ngritje të lehtë në nivelin e hemoglobinës së glikolizuar. Sidoqoftë, dhe te tjerët kanë theksuar te njëjtën ngritje në pacientet që nuk agjërojnë si pacientet që agjërojnë dhe te tjerët kanë treguar një kthesë në vlerat initiale të menjëhershme pas muajit të ramazanit.

Vlera e fructosamines. Insulinë, C- peptide gjithashtu ka qenë e raportuar që nuk kanë ndryshime sinjifikante para dhe gjatë muajit të Ramazanit.

Energjia e shfrytëzuar dhe variacionet e lipideve në serum gjatë agjërimit të Ramazanit te diabetikët.

Vlera e energjisë (kalisë) së marrë në disa literatura të raportuara është dhënë si zvogëlim i marrjes së energjisë.

Shumë paciente jo insulinë vares (NIDDM, Diabetes mellitus Typ II) dhe insulinë vares (IDDM, Diabetes mellitus typ I) nuk kanë treguar ndryshim ose vetëm zvogëlim të lehtë në kolesterolin total dhe trigliceride. Ngritja e nivelit të kolesterolit total gjatë Ramazanit rrallë ndodh. Si te personat e shëndoshë, disa studime kanë raportuar ngritje të lipoproteineve me densitet të lartë (HDL), kolesterolin të diabetikët gjatë Ramazanit. Një raport i dhënë në ngritje të lipoproteineve me densitet të ulët (LDL) kolesterol dhe zvogëlim të HDL kolesterolit.

Deri atëherë ka qenë standardizimi (kriteri) i diabetit në hulumtimet e Ramazanit në 3 faktor fundamental 3D tri D trekëndëshi i regjimentit të barërave, kontrolli i dietës dhe aktiviteti ditor–dobitë ose rreziku i agjërimit të Ramazanit në lipidet e serumit të diabetikëve është i paqartë.

Parametrat tjerë biokimik gjatë agjërimit të Ramazanit të diabetikët. Vlerat e Serum kreatininies, ac.uric, urea në gjak, Nitrogjeni, proteinet, albumina, alanina amino-transferaza, asparatamino-transferaza nuk treguan ndryshim sinjifikant gjatë periodës së agjërimit. Ngritja jo sinjifikante e lehte në disa parametra biologjike mund të jenë të përshtatshme për adaptimin metabolik dhe dehidrimin dhe të mos ketë asnjë prezantim klinik.

Direktivat (porositë e agjërimit) të diabetikët;

Gjatë 2 dekadave të fundit një kuptim i mirë i ndryshimeve gjatë agjërimit të Ramazanit në pacientët me diabetes është dhënë në disa porosi (broshura)se si të këshillojmë diabetikët të cilët dëshirojnë të agjërojnë. Mjekët që punojnë me myslimanët diabetik duhet të punësojnë të rinj të përshtatshëm që të këshillojnë pacientët e tyre për sigurinë e agjërimit të Ramazanit.

Kriteret që vijnë mund të ndihmojnë në marrjen e këtyre vendimeve:

Ndalimi i agjërimit në:

- Te tipi i diabetes mellitus typ I
- Diabetes mellitus typ II i kontrolluar në mënyrë të varfër
- Pacientët diabetik që janë të pakuptueshëm në lidhje me këshillat për dietë dhe regjimin medikamentoz dhe aktiviteti ditor.
- Pacientët diabetik me komplikime serioze siç është angjina jostabile ose hipertensioni i pakontrolluar
- Pacienti me histori të ketoacidozes

diabetike

- Pacientët diabetik në shtatzëni
- Pacientët diabetik me infeksione të brendshme
- Pacientët e vjetër me probleme të ndryshme
- 2 ose më shumë episode të hipoglikemise ose hiperglikemise gjatë Ramazanit.

Agjërimi i lejuar:

- Pacientët të cilët nuk kanë kritere të përmendura
- Pacientët që i pranojnë këshillat mjekësore.

Inkurajimi i agjërimit:

- Të gjithë pacientët e me peshë të shtuar NIDDM (jo insulinë vares – përveç shtatzënave ose lehonave) ato tek të cilat diabeti është stabil me peshë 20% më tepër se pesha ideale ose indeksi trupor (pesha e trupit, kg/lartësi, matje në metër) më tepër se 28.

Rëndësi të veçantë ka:

Edukimi i Diabetikëve para Ramazanit

NIDDM pacientët (jo insulinë vares) dhe IDDM pacientët të cilët insistojnë në agjërime duhet të rekomandojmë disa rekomandime në lidhje me agjërimin. Ata duhet të ndalohen nga ushqimet e shpeshta, marrja e medikamenteve në mënyrë jo të rregullt ose ushqimin jo adekuat pas ndërprerjes së agjërimit.

Principet e konsideruar të para – Ramazanit:

- (a) Vlerësimi i gjendjes fizike të mirë
- (b) vlerësimi i kontroles metabolike
- (c) Adaptimi i protokollit të dietës për agjërimin e Ramazanit
- (d) Adaptimi i regjimit të medikamenteve e.g. ndryshimet në barërat hipoglikemike me veprim të gjatë ndaj atyre me veprim të shkurtër që mbrohet hipoglikemia:
- (e) Inkurajimi për vazhdimin e aktivitetit fizik të caktuar.
- (f) Njohja për simptomat e vërejtura si dehidrimi, hipoglikemia dhe të tjera mundësi të komplikimeve.



H. HAFIZ MAHMUD DASHI

(1873-1961)

**I DEKORUARI PËR VEPRIMTARI
PATRIOTIKE**

Shkenca e edukimit bashkëkohor, përfshirë edhe pedagogjinë, shkrijnë në një veprimtarinë edukative të teologut, pedagogut, didaktit, kur këto fusha janë zhvilluar në nivelin e duhur. Këto drejtime veprimtarie janë harmonizuar e shkrië natyrshëm në personalitetin e Haxhi Hafiz Mahmud Dashit nga Tirana.

I lindur në Tiranë në vitin 1873, Mahmud Dashi trashëgoi traditën e pasur të familjes e të paraardhësve të tij në fushën fetare e atdhetare, me aftësinë e theksuar rrezatuese të mikro e makromjedisi i tyre nëpërmjet fjalës së zgjedhur e të argumentuar, e cila natyrshëm shkonte drejt e në zemrat e mendjet e të pranishmëve. Ai ishte një interpretues i aftë i Kur'anit dhe i Hadithit. Punoi si profesor i jurisprudencës islame në Medresenë e Përgjithshme të Tiranës deri në vitin 1961, kur ky institucion u mbyll nga regjimi monist, vit në të cilin ndërroi jetë edhe hafizi.

Mahmud Dashi i dha përparësi të veçantë punës edukative me njerëzit, duke nënvizuar se, nuk ka njeri të paedukueshëm, se me njeriun duhet menduar e gjetur gjuha, që edhe ujku të zbutet, e të mos mbetemi duke u marrë vetëm me qengjat.

Veprimtaria e tij ishte shumë e gjerë. Ai nuk mjaftohej vetëm me ngarkesën mësimore në Medresenë e Tiranës, por punoi edhe si predikues në xhaminë e rrugës së Kavajës, e cila sot quhet "Xhamia e Haxhi Hafiz Mahmud Dashit".

Veprimtaria e tij pedagogjike la gjurmë të thella te shumë nxënës, mjaft prej të cilëve punuan e u afirmuan si personalitete të shquara kombëtare e fetare, arsimore e kulturore, në mes të të cilëve shquhen studiues të shquar orientalistë si Vexhi Buharaja, teologë e studiues si Hasan Selami, Ejub Faslia, Haki Repishti, studiues si Shaban Demiraj në fushën filologjike, etj.

Veprimtaria atdhetare e Mahmud Dashit është vlerësuar me dekoratën "për veprimtari patriotike", për një aktivitet të pandërprerë në dobi të kulturës kombëtare.

Kështu, teologu dhe pedagogu i shquar ka hyrë me dinjitet në historinë e kulturës shqiptare e të arsimit në veçanti, duke mbetur një shembull i madhërishtëm i edukatës dhe i kulturës shqiptare.

Ai në medrese jepte mësim lëndën e besimit, bazën e fesë islame, themelin e saj, sepse çdo punë e veprimtari që bën njeriu gjatë gjithë jetës së tij, ngrihet mbi bazën e besimit të tij të singërtë: Paqe me Zotin, me shoqërinë e vetveten.

Lëndën e besimit që ai ia mësonte nxënësve e shtrinte në tre plane:

a) Në planin vertikal - që përfshinte marrëdhëniet e njeriut me Krijuesin e gjithësisë. Si ta njohim, ta besojmë, falënderojmë e të punojmë me urdhëresat e Tij, t'i lutemi e adhurojmë vetëm Atë, vetëm tek Ai të mbështetemi, shpresojmë e pendohemi.

b) Në planin horizontal, shpjegonte si duhet t'i ndërtojmë marrëdhëniet tona me shoqërinë, me komunitetin, me fqinjët, farefisin, prindërit, familjen, fëmijët.

c) Në planin vetjak. Mësimet e fesë islame që u mësonte mësues H. Mahmud Dashi nxënësve, theksonin se, njeriu që lind, lind pa mëkate, nuk trashëgon e nuk përgjigjet për mëkatet e paraardhësve, qofshin prindërit; u mësonte atyre si të veprojnë me vetveten, si ta ruajnë trupin që Krijuesi i gjithësisë na e ka dhuruar të përsosur, na e ka dhuruar ta ruajnë, ta mbrojmë, ta vëmë në dispozicion të shoqërisë, ta njohim botën, ta studiojmë atë, ta ndryshojmë në dobinë tonë, të veprojmë pozitivisht mbi të e jo ta shkatërrojmë.

Haxhi Dashi ishte fjalëpakët, fliste ngadalë, me zë të ulët, por fjala e tij ishte bindëse e zinte vend, sepse shqiptohej nga goja, por ajo dilte nga zemra, mendja e shpirti i tij; ishte fjalë e vepër, prandaj mësimet e Islamit që ai mësonte nguliteshin në mendjet e nxënësve.

Ai kishte marrëdhënie shumë të mira me nxënësit, shpjegonte qartë e kuptueshëm me shumë shembuj konkret. I inkurajonte ata gjithmonë, i afronte, kurrë nuk i ndëshkonte dhe i bënte për vete me respektin reciprok.

I pëlqenin aktivitetet kulturore e sportive që nxënësit zhvillonin në kohën e lirë. Nxënësit kishin gjithashtu grupin teatral dhe përgatisnin shfaqje, si historinë e Hz. Jusufit, dramën Halili dhe Hajrija, elegji për Qerbelanë, këndimin e Mevludit, etj. Ai i ndiqte me dëshirë shfaqjet që jepeshin në sallën e shkollës.

Sa i afërt ishte me nxënësit aq edhe autoritar ishte, por jo imponues. Respektin e fitonte me qëndrimin e tij, me gatishmërinë e tij për t'i ndihmuar nxënësit në çdo gjë që ata pyesnin.

Gëzonte autoritet dhe respekt dhe ndaj kolegëve e pedagogëve të tjerë që jepnin mësim në medrese.

Bisedat e tij ditëve të premte ishin të goditura dhe aktuale dhe dëgjoheshin me vëmendje nga xhemati dhe nga nxënësit që shpesh shkonin për të falur xhumanë atje.

Ai ishte i afërt me besimtarët që frekuentonin xhaminë dhe interesoheshin për ta, për nevojat e shqetësimet e tyre dhe shpesh i vizitonte ata dhe në shtëpitë e tyre. Nga të gjithë ishte i respektuar.

Lartësimi dhe përhapja e *Qytetërimit Islam*

Para se të meditojmë përmbi të ardhmen e njerëzimit në këtë mijëvjeçar të ri, do të ishte me vlerë të shqyrtonim mijëvjeçarin që sapo përfundoi, dhe veçantitë e tij të natyrshme, duke qenë i mbushur plot me ngjarje të mëdha. Një mijë vjetët e fundit dëshmuuan rënien dhe ngritjen e qytetërimeve, luftëra dhe kundërshti fetare apo kombëtare e racore, grupime dhe shpërndarje a gjymtime popujsh a shtetesh, dhe një këmbëngulje në rritje për të drejta njerëzore, paralel me rritjen e mizorisë dhe dhunimit.

Islami u shfaq në një stad të historisë, në një kohë të vështuar si më të errëtat e historisë njerëzore. Një kohë kur fetë e mëparshme kishin dalë nga udha e profetëve, dhe kishin përfunduar nga fe, në kulte.

Në këtë periudhë të historisë njerëzore, lindi dhe mori shpalljen hyjnore profeti Muhamed a.s.

Të ndezur nga afshi i përhapjes së thirrjes islame për në Zotin Një, e për një botë drejtësie, barazie e vëllazërimit, ndjekësit e profetit Muhamed a.s. arritën që më se një shekull prej vdekjes së tij, ta shpalosin flamurin e Islamit përmes Afrikës Veriore e Spanjës, drejt Pirenejve në Francë e mes Persisë, Indisë e Turkistanit, deri në kufijtë e Kinës.

Profesor Philip Hitti me të drejtë nënvizon se në 100 vitet pas ndërrimit jetë të Profetit a.s., pushteti i mëkëmbësve të tij, kishte marrë formën e një shteti botëror, të shtrirë nga Kina në Francë.

Dinastia e madhe emevite, me bazë në Damask (661-750), dhe më e madhja se ajo, dinastia abasite, në Bagdad (750-1258), dhe të tjera dinasti të përmendura, si ajo e fatimidëve në Kairo apo sërish e emevive në Kordovë, janë të rëndësishme në kapitullin e historisë islame. Myslimanët sollën me to, një qytetërim të freskët, një mënyrë tjetër të të vështuarit dhe të jetuarit të jetës; ata erdhën në skenën botërore për të qenë personazhe kryesore.

Me qëllim që të shpjegojnë përhapjen e furishme e fenomenale të Islamit në kohët e para të tij, kritikët shpesh kanë sugjeruar se myslimanët kanë vringëlluar shpatat për të hapur fenë e tyre revolucionare. Shkrues të ndryshëm perëndimorë e kanë përshkruar luftëtarin musliman me shpatën në një dorë dhe me Kur'anin në tjetrën. Por ama çdokush e di mirë se shpata nuk është frytdhënëse si një mënyrë për të futur njerëzit në fe.

Duhet parë për shkaqe të tjera. Duhet parë në bukurinë, në thjeshtësinë dhe barazinë që rrezaton Islami, i cili ofronte një baraspeshë midis çështjeve të botës e atyre të fesë, duke e tërhequr kështu natyrshëm njerëzinë kudo.

Will Durant, një i krishterë i devotshëm dhe një kritik i njohur i Islamit, megjithatë shkruan:

"Në Kur'an nuk ka vetëm rregulla për sjelljet e mira dhe pastërtinë, martesën e ndarjen, e trajtimin e



fëmijëve, skllëvërve e kafshëve, por gjithashtu për tregtinë e politikën, interesin dhe borxhin, marrëveshjet dhe trashëgiminë, industrinë dhe financat, krimin dhe ndëshkimin, luftën e paqen. Muhamedi a.s. i kërcënoi me ferrin, tregtarët mashtrues e të pandershëm, denoncoi spekulatorët e monopolistët të cilët grumbullonin mallra për t'i shitur më pas më shtrenjtë, urdhëroi punëdhënësit t'i japë punëtorit shpërblimin para se t'i thahet djersa. Ai ndaloi të jepet a të merret interesi (fajdeja). Asnjë reformator më mirë se ai nuk u vuri taksa të pasurve për të ndihmuar të varfrit. Dallimi në racë apo sërë, kaq i fuqishëm midis fiseve të kohës, u zvogëlua prej besimit të njëjtë; siç edhe ai tha: 'Edhe nëse një skllav i zi caktohet t'ju udhëheqë, dëgjojeni e bindjuni atij...'

Veç kësaj, ndikim pati edhe fakti që dijetarët e Islamit iu dhanë me mish e shpirt grumbullimit të thesareve të vjetra të dijeve dhe arteve.

Veprimtaria mendore e myslimanëve të hershëm, përgjithësisht klasifikohet në dy: në atë çka ishte fillësë e arabëve si gjuhësia, letërsia, teologjia, ligjshmëria e historia, si edhe atë çka ishte përftesë prej takimeve me popujt e tjerë, si filozofia, matematika, astronomia, mjekësia, shkencat natyrore e gjeografia etj. Nevoja e mbajtjes në këmbë të strukturës madhore së një rendi politik e shoqëror në shtetin islam, në mënyrë që kjo strukturë të buronte e të mbështetej në Kur'anin e shenjtë dhe në shembullin e Profetit, bëri që fillimisht dijetarët myslimanë të shkëlqenin në grupin e parë të shkencave.

Myslimanët e nisën aventurën e tyre intelektuale me përkthimet voluminoze nga persishtja, sanskritishtja, siriakishtja e greqishtja. Gjatë fazës së përkthimeve (750-850), u arrit një situatë e tillë, gjatë së cilës, bota myslimane të kishte në duart e saj kryeveprat e lashtësisë prej kulturave të ndryshme, dhe mundësinë për t'i përsosur më tej këto kryevepra.

Kështu, duke filluar nga gjysma e shekullit të nëntë, myslimanët filluan një epokë ndihmesash vetjake në shkencë, duke kapërcyer kështu fazën e përkthimeve.

Në pak shekuj ata prodhuan disa prej shkencëtarëve, filozofëve, historianëve dhe juristëve më të mirë të njerëzimit. Në këtë periudhë, tokat e tyre ishin qendra të qytetërimit dhe mendjendriçimit. Përparimi, zhvillimi dhe animi i përgjithshëm për nga toleranca, ishin në një kontrast të thellë me prapambetjen, varfërinë dhe fanatizmin që mbanin shtrënguar Evropën e kohës.

Historiani Stanley Lane-Poole, shkruan: "Dymbëdhjetë mijë vjet më parë, Tarik Mauri (Tarik bin Zijad), ia shtoi tokën e Vizigotëve (Spanjën) katalogut të pasur të mbretërive të rëna në duart e myslimanëve. Për më se tetë shekuj, nën prijësit e saj myslimanë, Spanja i dha gjithë Evropës një shembull të shkëlqyer të një shteti të qytetëruar. Aty, krahinat pjellore u kthyen dyfish prodhimtare prej aftësive teknike të zotëruesve të saj.

Arti, letërsia dhe shkencë përparuan si jo tjetërkund në Evropë. Studentë nga Franca dhe Gjermania dhe Anglia vërshonin për të pirë prej burimeve të dijes të cilat rridhnin prej qyteteve të myslimanëve. Kirurgët e mjekët e Andaluzisë ishin pararoja e shkencës së kohës; gratë mbështeteshin për të studiuar seriozisht.

Matematika, astronomia, botanika, historia filozofia e jurisprudenca arritën stadi mjeshtëror në Spanjë. Metoda shkencore e irrigimit të ujërave, artet e fortifikimit dhe të anije-ndërtimit, prodhimet më të rafinuara të cohës, veglat e gdhendësve dhe poçarëve u përmirësuan në këtë kohë nga banorët e Spanjës.

Në praktikën luftarake jo më pak se në artet e paqes, ata qëndruan mbi të tjerët për një kohë të gjatë. Gjithë çka e bëri një mbretëri të madhe dhe të përparuar, gjithë çka çon drejt përsosjeve dhe qytetërimit, mund të gjendej në Spanjën myslimane."

Efektet Psikologjike të *Agjërimit*



Megjithëse nuk gjenden shumë studime në lidhje me efektet e agjërimit mbi strukturën psikologjike të njeriut analizimi i një teme të tillë është shumë i rëndësishëm. Kur vlerësojmë efektet e agjërimit mbi njeriun në ndajmë ato në tre pjesë: efektet biologjike, psikologjike dhe sociale.

Kur njeriu agjëron, qëndron pa ngrënë dhe pa pirë për një kohë të caktuar dhe si rezultat i këtij procesi krijon një përgjigje ndaj stresit. Gjatë agjërimit njeriu ndoshta dhe pa e kuptuar zhvillon një ushtrim kundër stresit. Agjërimi na bën më të forte dhe më të qëndrueshëm ndaj stresit. Zakonisht personat të cilët njihen si më të stresuar dhe agresivë gjatë muajit të Ramazanit janë më të qetë. Në mënyrë të ngjashme edhe personat të cilët konsumojnë rregullisht alkoolin gjatë muajit të Ramazanit shpesh nga ai dhe heqin dorë përfundimisht.

Agjërimi shoqërohet me një qetësi shpirtërore, me durim dhe besim në shpërblimin shpirtëror për sakrificën e bërë vetëm për hir të Zotit (xh.sh). Nisur nga ky fakt mund të themi se agjërimi i muajit të Ramazanit ndikon në minimizimin e ankesave depresive, gjendjeve të ankthit dhe çrregullimeve të vartësive të ndryshme.

Zgjidhje në syfyr të mbron nga depresioni

Zgjidhje në syfyr është i ngjashëm me metodën e privimit të gjumit të aplikuar në kurimin e depresionit. Prandaj mund të themi se ngritja në syfyr ndihmon shumë në luftimin e depresionit.

Agjëruesi ushtron veten duke kontrolluar etjen, urinën, sjelljet agresive, zemërimin etj. Si rrjedhojë mund të themi se agjërimi mundëson një prirje pozitive në kontrollimin e impulseve. Besimi në Zot e ndihmon njeriun të gjejë kuptimin e vërtetë të jetës dhe vdekjes. Lidhja e njeriut me besimin dhe realizimi i praktikave fetare siguron një botë shpirtërore të shëndetshme si dhe një harmoni sociale. Në të njëjtën kohë zhvillon dhe aftësinë e empatisë.

Gjatë agjërimit të muajit të Ramazanit njeriu me anë të urisë së përjetuar arrin të kuptojë më mirë gjendjen e të varfërve, të cilët çdo ditë përballen me urinë si një pjesë të dhimbshme të jetës së tyre. Kuptimi i gjendjes dhe ndjenjave të tjetrit është edukim i aftësisë së empatisë. Krijon një barrierë me personalitetin narcist, egoizmin dhe indiferentizmin. Adhurime si iftari dhe falja e namazit të teravive i hapin rrugë

socializimit ndërsa dhënia e lëmoshës dhe zekatit, i hap rrugë solidaritetit.

Adhurimet e bëra në Ramazan e ndihmojnë njeriun të përmirësojë veten dhe të bëhet më i dobishëm për shoqërinë duket ndikuar pozitivisht në anën e tij psikosociale.

Anët pozitive të agjërimit:

Muaji i ramazanit është një muaj ideal nëse dëshironi të rifitoni zakone të reja. Probleme të ndryshme si mungesa e kontrollimit të zemërimit, sjelljet impulsive, çrregullimet e të ngrënit, problemet në komunikim mund të shndërrohen në sjellje pozitive.

1. Depresioni pakësohet me anë të falenderimit:

Falenderimi është një ushtrim i çmuar për zemrat tona. Me anë të falenderimit zhvillohen ndjenja positive. Një person i cili falenderon për ato që ka ndihet mire me vetveten dhe vlerëson çdo gjë rreth vetes.

2. Me rritjen e empatisë zhvillohen edhe aftësitë sociale:

Agjëruesi arrin të kuptojë gjendjen e të uriturit dhe të gjithë krijesave që e rrethojnë. Agjërimi ndikon pozitivisht në marrëdhëniet me të tjerët. Ndjeshmëria dhe solidariteti i sjellë nga agjërimi e bën njeriun më të shëndetshëm nga ana psikosociale.

3. Pakësohet ankthi dhe rritet ndjenja e sigurisë:

Muaji i Ramazanit është muaji i afërimit me Krijuesin e gjithësisë. Të qenurit afër me Zotin të jep një ndjesi sigurie duke pakësuar ndjenjat e ankthit. Agjërimi është shumë efektiv në plotësimin e nevojave fiziologjike të personave të stresuar dhe ankthioz.

4. Durimi është kushti parësor i përmirësimit:

Duke pritur syfyrin e iftarin agjëruesi kultivon ndjenjën e durimit. Duke mësuar kontrollimin e nevojave themelore si uria dhe marrëdhëniet seksuale minimizon çrregullimet psiko-sociale.

5. Minimizohen çrregullimet obsesive:

Mendimet e fiksuara të cilat i hapin rrugë stresit akut minimizohen me ndihmën e agjërimit. Vullneti fizik i hap rrugë dhe vullnetit njohës. Njeriu që kontrollon mendimet arrin të menaxhojë dhe dinamikat shpirtërore.

6. Forcon lidhjet familjare:

Ngrënia e syfyrin dhe iftarit së bashku ndikon pozitivisht në sjelljen e individit, në përmirësimin e gjendjes së tij psikologjike dhe në forcimin e marrëdhënieve familjare dhe shoqërore.



A MUND T'I ZËVENDËSOJMË Lotët

Kur mendojmë për lotët në përgjithësi mendojmë për shkaqet emocionale prapa tyre, sepse një person që po qan ka lot në sytë e tij. Ky sigurisht që është një nga funksionet e tyre të rëndësishme, megjithatë lotët janë shumë më të dobishëm se sa mund të na duket.

Lotët luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e aktiviteteve vitale të syve dhe kornesë, një ind me një kapacitet të lartë për rigjenerim që nuk përmban asnjë enë gjaku pavarësisht numrit të madh të nervave që zotëron së bashku me faktin se afërsisht 75 deri në 80 % e peshës së tij është uji. Lotët gjithashtu ndihmojnë indet e syrit duke shërbyer si një pengesë kundër agentëve të jashtëm që mund të shkaktojnë infeksione dhe kështu ndihmojnë në sigurimin e mprehtësisë vizuale. Për më tepër, ato janë një burim i faktorëve të rritjes, vitaminave, neuropeptideve dhe substancave të tjera që kërkohen për zhvillimin dhe rritjen e epitelit të kornesë, një strukturë transparente pa asnjë enë

gjaku që ndodhet në pjesën e përparme të syrit.

Në shikim të parë, lotët mund të duken si pika të thjeshta uji. Sidoqoftë, ato janë në të vërtetë lëngje viskoze që mbrojnë sytë dhe përmbajnë elektrolite, ujë, mucin, vitaminë A, proteina antimikrobike, imunoglobulina dhe faktorë të rritjes. Ata shpesh sekretohen në mënyrë të pavullnetshme si rezultat i stimulimit të sipërfaqeve të syve dhe mukozës së hundës, dhe një person është i aftë të prodhojë një mesatare ditore prej 10 ml lotësh. Një pjesë e konsiderueshme e lotëve humbet përmes avullimit ose thithjes nga sistemi nasolakrimal, i cili është një sistem shumë i sofistikuar, funksionet e të cilit nuk dihen ende plotësisht, që shërben si një tubacion për bartjen e lotëve në mënyrë që të mos dalin nga sytë tanë. Lotët gjithashtu kanë karakteristika antimikrobike, lëndë ushqyese dhe optike. Mungesa e lotëve të mjaftueshëm prish këtë ekuilibër dhe mund të çojë në dëmtimin e indeve epiteliale. Prodhimi i lotëve mund të bjerë

për shkak të plakjes, gjumit, anestezisë, ndjeshmërisë së hundës të zvogëluar, Sindromës së Syrit të Thatë (DES) ose zhvillimit të keratokonjunktivitis sicca (KCS).

DES rezulton në sy të thatë për shkak të prodhimit të ulur, ose avullimit të shtuar, të lotëve ose dëmtimit të sipërfaqeve të syve. Simptomat e saj përfshijnë acarim, ndjesi pickimi, vizion të paqartë dhe shikim të ulët. DES është më i shpeshtë midis njerëzve të moshës mbi 65 vjeç dhe grave në menopauzë.

Në kujdesin parësor, DES trajtohet me lot artificial. Sidoqoftë, lotët artificialë përmbajnë sasi të pamjaftueshme të yndyrave dhe për këtë arsye mund të rrisin shkallën e avullimit midis lotëve ekzistues sepse ato nuk arrijnë të sigurojnë rigjenerimin dhe riparimin e duhur të epitelit. Për këtë arsye, janë duke u zhvilluar kërkime për trajtime më efektive. Ashtu si qumështi i gjirit është thelbësor për foshnjat dhe nuk mund të zëvendësohet me formula të menjëhershme, lotët natyralë janë po aq të vlefshëm për sipërfaqet e syve. Në këtë kontekst, ka përpjekje të vazhdueshme për të prodhuar lotë alternative duke përdorur lëngje të tjera të trupit si gjak, qumësht gjiri, acid hialuronik dhe gjaku i kordonit të kërthizës.

Mund të duket e çuditshme, por gjaku është lëngu i parë trupor që vjen në mendjen e studiuesve në kërkimin e tyre për prodhimin e lotëve alternative pasi përmban shumë lëndë ushqyese dhe terapeutike. Serumi autolog i prodhuar nga gjaku i dikujt u propozua për përdorim për shkak të përmbajtjes së tij të ngjashme me atë të lotëve natyralë. Trajtimi me serum autolog u prezantua për herë të parë nga Ralph et al. në 1975. Fox etj. raportoi më pas rezultate pozitive në 1984 për përdorimin e serumit autolog në trajtimin e syve të thatë, megjithatë zbatimi i tij klinik u krye nga Tsubota et al.

Tsubota argumentoi se serumi autolog ishte më i favorshëm se lëngjet e tjera pasi rreziku i transmetimit të sëmundjeve ishte më i ulët. Lotët e bërë nga gjaku i kordonit të kërthizës dhe serumi i gjedhit u përdorën gjithashtu për këtë qëllim, por ato nuk u konsideruan si të sigurta ose praktike për shkak të rrezikut të infeksionit dhe reaksionit alergjik. Serumi përmban IgG, substanca me efekte antibakteriale si lizozima, vitamina A, albumina, a2 makroglobulina, faktori i rritjes së trombociteve 19 (PDGF) dhe shumë substanca të tjera që kanë efekt ushqyes në qelizat epiteliale. Të gjitha këto substanca gjenden në sasi më të mëdha në serum autolog se sa lotët, dhe për këtë arsye produktet e gjakut të tilla si serumi autolog i marrë nga i njëjti person, ose nga të afërmit e shkallës së parë, janë një mundësi e mirë në kërkimin e lotit perfekt alternativ.

Me të parë një vështrim më të afërt, metoda e trajtimit të DES me serum autolog është një metodë shumë më e vjetër se sa mund të imagjinohet. Ka histori të famshme popullore në të cilat njerëzit humbin shikimin për shkak të të qarave të tepërta nga pikëllimi. Libri i Dede Korkut përmban histori të tilla [10]. Për shembull, "Bamsi Beyrek i Kalit Gri" rrëfen historinë e Bamsi Beyrek i cili u zu rob dhe njerëzit nuk mund të merrnin asnjë lajm për të për një kohë të gjatë. Më vonë, kur erdhi lajmi për vdekjen e tij, babai i tij Princi Püre qau për vite me rradhë, por më vonë, ai mësoi

se djali i tij nuk kishte vdekur dhe u kthye.

"Lajm i lumtur për ju, Prince Bay Püre; djali juaj u kthye, "tha Princi Kazan.

"Për të ditur nëse ai është me të vërtetë djali im, le të bëjë që gishti i tij i vogël të rrjedhë gjak dhe të fshijë gjakun me një shami, dhe më lër ta fshij në sytë e mi, dhe nëse sytë e mi rimarrin shikimin, atëherë ai është me të vërtetë djali im Beyrek, "Tha Princi Bay Püre. Kur ai fërkoj shaminë në sytë e tij, ai e rimori shikimin me fuqinë hyjnore të Zotit ".

Çrregullimi i syve nga i cili vuajti Princi Püre në këtë histori është me të vërtetë DES. Historia përshkruan se si një produkt gjaku aplikohet lokalisht në sipërfaqen e syrit dhe si rezultat, shikimi riftohet. Ekziston një qëllim i mençur t'i thuash Bamsi Beyrek-ut që të mos bëjë që gishti i tij i vogël të rrjedhë gjak drejtpërdrejt në sytë e babait të tij. Gjaku u ngjiz dhe gjaku i ngjizur mbeti në shami. Gjaku pa mpiksje (serum) u filtrua në anën tjetër të shamisë dhe ky serum u bë shërimi i sëmundjes. Sipas historisë, nëse ky serum funksionon, kjo dëshmon se gjaku është nga linja e gjakut e personit të sëmurë, d.m.th., nga një i afërm i shkallës së parë.

Një histori e ngjashme mund të gjendet në Suren Jusuf të Kur'anit të Shenjtë. Profeti Jakub, paqja e Zotit qoftë mbi të, qau shumë kur djali i tij, Profeti Jusuf, paqja qoftë mbi të, u zhduk pasi u hodh në një pus nga vëllezërit e tij, u rrembye nga një karvan dhe më pas u dërgua në Egjipt. Siç përshkruhet në Kur'an: "Ai u kthye nga ata dhe tha: "Mjerisht, pikëllimi im për Jusufin! " Dhe sytë e tij u bënë të bardhë për shkak të hidhërimit "(Sure Jusuf, 12:84). Vargjet e mëposhtme përshkruajnë se si Profeti Jusuf i dërgoi këmishën e tij të lagur me djersë babait të tij Profetit Jakub, i cili riktheu shikimin kur i fërkoj këmishën e djalit të tij në sytë e tij: "Shko me këtë këmishën time dhe vër atë mbi fytyrën e babait tim, dhe ai do ta shërojë shikimin e tij "(Sure Jusuf, 12:93). "Por kur erdhi lajmëtar i (me këmishën e Jusufit), Jakubi e vuri mbi fytyrën e tij dhe ai e riftoi shikimin" (Sure Jusuf, 12:96).

Profeti Jakub rigjeti shikimin e tij pasi vendosi këmishën e lagur me djersë të Profetit Jusuf lokalisht në sytë e tij nënkupton që djersa mund të shërbejë si një alternativë ndaj lotëve.

Lëkura e njeriut ka një mesatare prej 2.6 milion gjëndra djerse dhe 99% e djersës është ujë. Kërkimet treguan se djersa e njerëzve të shëndetshëm kishte një erë tjetër nga ajo e njerëzve të sëmurë për shkak të përbërjeve organike të paqëndrueshme në djersë. Djersa e secilit ka një erë unike në varësi të shëndetit, emocioneve dhe dietës së tij. Përzierja e 373 përbërjeve të paqëndrueshme në djersë e bën atë unike si një gjurmë gishtash. Në vitin 2013, një inxhinier suedez zhvilloi një makinë që mund të shndërrojë djersën në ujë dhe tregoi se dikush mund të merrte një gllenjkë ujë nga një këmishë e lagur me djersë. Dihet që struktura e proteinave antibakteriale e quajtur dermicidin në djersë është thelbësore në parandalimin e aktiviteteve bakteriale dhe luftimin e infeksioneve.

Studiuesit mund të gjejnë frymëzim nga mënyra se si Profeti Jakub riftoi shikimin e tij falë një këmishë të lagur nga djersa, erës së Profetit Jusuf dhe përmbajtjes terapeutike në të duke marrë parasysht karakteristikat e lartpërmendura.

Përktheu: Erion Sukaj

Fugëza e shkretë dhe të mëdhenjtë

- Do të kini një fugë për Bajram, dhuratë feste, - na tha vëllai i madh dhe ne, fëmijët, u gëzuan shumë.

- Urra!.. - bërtitëm në kor, pa e ditur se çfarë sendi ishte ai që do të na dhuronin të mëdhenjtë për festë.

Dhurata ishte gati, e kishin prurë në dhomën pranë. Atje hyri vëllai ynë i madh bashkë me një shokun e vet. Ata ishin të rritur, dy herë më të mëdhenj në moshë sesa ne.

Kur ata hynë në dhomën tonë, shoku i vëllait nxori nga xhepi një send të vogël, mbështjellë me kujdes në një shami të kuqe. E çmbështolli me ngadalë shaminë dhe ne pamë një fugëz të praruar kauçuku, që kishte formën konike të plumbçes së muratorit.

I pari e mora unë në dorë fugëzën. E shihja me dashuri dhe nuk i ngopesha dot duke e parë me sy. Ajo ishte e bukur, e vogël dhe e lehtë pendë.

E morën nëpër duar edhe të tjerët, duke iu gëzuar asaj vetëm për pak çaste.

- Fugëza, fugëza!.. Urra!.. - thirrëm pastaj të gëzuar dhe plot hare.

- Përse bën kjo, fugëza?! - pyeti Beni i Dakos, teksa po e vërtiste sendin nëpër duar, duke e ledhatuar dhembshurisht, si një gjë të gjallë e delikate.

- Kjo është lodër, - tha vëllai dhe sakaq u krekos, duke u mbajtur me të madh. - Lodërzë... Atë e vendos në një vend të sheshtë e të fortë, i jep pak të përdredhur rreth vetes në fillim dhe ajo vërtitet pa pushim, si kali në lëmë.

Ne zgjodhëm menjëherë një vend

të mirë, të pastër, dyst e të fortë dhe të mëdhenjtë e bënë fugën të vërtitet rreth vetes. U kënaqëm të gjithë. Mbajtëm frymën për një çast dhe nuk guxonim as të flisnim, nga frika se mos fugëza papritur trembej dhe e ndalonte vërtitjen rreth vetes.

Fugëza vazhdonte të vërtitej pa u ndjerë, rrotullohej e rrotullohej rreth vetes dhe nuk kishte ndër mend të pushonte. Heshtëm për një kohë të gjatë. Heshtnin edhe të mëdhenjtë dhe kush e di çfarë mendonin, mbase ndiheshin të habitur edhe vetë që na e kishin zgjedhur atë dhuratë interesante. Dëgjoheshin vetëm "fësh-fëshet" e vërtitjeve të dhuratës sonë.

- Ore, po kush xhanëm e rrotullon kështu kaq gjatë këtë të shkretë?! - e theu heshtjen i pari ai shoku i vëllait tonë të madh.

- Ku ta dish, - pëshpëriti i ngrysur në fytyrë vëllai ynë, i zhytur thellë në mendime.

- Çfarë mund të ketë brenda?

- Ku ta dish?

Çudi e madhe, besa!..

Ne e dëgjonim gojëhapur bisedën plot pasthirrma e pyetje të të mëdhenjve, pa e larguar vëmendjen nga "fësh-fëshet" e fugës së vogël, që vërtitej e vërtitej pa pushim. Na vinte ta kapnim me dorë atë dhuratë të çmuar, ta përkëdhelnim e ta ledhatonim si një zog të gjallë e me shpirt, t'i thoshim fjalë të mira e ta puthnim. Po kishim frikë, se po ta zinim me dorë, asaj do t'i prishej drejtpeshimi, pastaj do të na

zemërohej dhe nuk do të na bindej tjetër herë.

- E dini ç'ë, o kalamaj... - foli prerë ai shoku i vëllait. - Edhe sonte do ta mbajmë neve fugën. Kemi për të kryer ca studime me të. Nesër jua japim përsëri.

Ai zgjati dorën e madhe e tërë damarë dhe e përfshiu sakaq lodërzën tonë të dashur, duke ia ndërprerë sakaq vërtitjen rreth vetes. Ne lëshuam vetëm një "Aaah! ", u mërzitëm pak, por na ngushëllonte shpresa se të nesërmen do ta kishim tërësisht tonën fugëzën tonë të mirë.

Po të mëdhenjtë nuk e mbajtën fjalën. Ata gjatë natës kishin kryer një masakër të urryer. E kishin ndarë në dy copa fugëzën e shkretë, për të parë e zbuluar se ç'kishte brenda saj, që e bënte të vërtitej e të vërtitej pa pushim. Kur e kishin bërë këtë, ishin habitur dhe kishin mbetur me gojë hapur, si guakë: fugëza ishte bosh përbrenda, fare bosh. Të zhgënjyer dhe të ndërkryer nga budallallëku i tyre, ata e kishin coptuar fare dhuratëzën tonë të dashur dhe copërat i kishin flakur tutje nga dritarja tërë inat.

Ne na erdhi shumë keq për fatin e zi të fugëzës së shkretë. Nuk pranua dhuratë tjetër për atë Bajram. Përse të prananim tjetër dhuratë nga ata që mbaheshin më të madh dhe që e hiqnin veten më të ditur se ne?!.

Dredhinë, pabesinë, paditurinë dhe shpirtngushtësinë e të mëdhenjve të paditur, shpirtligj e fodullë nuk e harruam kurrë.

Ramazan	Ditët	Prill Maj	*Agimi (Imsaku)	Lindja e Diellit	Dreka (Yleja)	Zamra (Iqindia)	Perëndimi (Akshami)	Darka (Jacia)
1	M.	13	04:21	06:00	12:48	16:28	19:25	20:52
2	M.	14	04:20	05:58	12:48	16:28	19:26	20:53
3	E.	15	04:18	05:57	12:48	16:29	19:27	20:55
4	P.	16	04:16	05:55	12:48	16:29	19:28	20:56
5	SH.	17	04:14	05:54	12:47	16:29	19:29	20:58
6	D.	18	04:12	05:52	12:47	16:30	19:30	20:59
7	H.	19	04:10	05:51	12:47	16:30	19:31	21:00
8	M.	20	04:08	05:49	12:47	16:30	19:32	21:02
9	M.	21	04:06	05:48	12:47	16:31	19:33	21:03
10	E.	22	04:04	05:46	12:46	16:31	19:34	21:05
11	P.	23	04:02	05:45	12:46	16:31	19:35	21:06
12	SH.	24	04:00	05:43	12:46	16:32	19:36	21:08
13	D.	25	03:58	05:42	12:46	16:32	19:37	21:09
14	H.	26	03:56	05:40	12:46	16:32	19:39	21:11
15	M.	27	03:55	05:39	12:45	16:33	19:40	21:12
16	M.	28	03:53	05:38	12:45	16:33	19:41	21:14
17	E.	29	03:51	05:36	12:45	16:33	19:42	21:15
18	P.	30	03:49	05:35	12:45	16:33	19:43	21:17
19	SH.	1	03:47	05:34	12:45	16:34	19:44	21:18
20	D.	2	03:45	05:32	12:45	16:34	19:45	21:20
21	H.	3	03:43	05:31	12:45	16:34	19:46	21:22
22	M.	4	03:42	05:30	12:45	16:35	19:47	21:23
23	M.	5	03:40	05:29	12:44	16:35	19:48	21:25
24	E.	6	03:38	05:27	12:44	16:35	19:49	21:26
25	P.	7	03:36	05:26	12:44	16:36	19:50	21:28
26	SH.	8	03:35	05:25	12:44	16:36	19:51	21:29
27	D.	9	03:33	05:24	12:44	16:36	19:52	21:31
28	H.	10	03:31	05:23	12:44	16:36	19:53	21:32
29	M.	11	03:30	05:22	12:44	16:37	19:54	21:34
30	M.	12	03:28	05:21	12:44	16:37	19:55	21:35

Jeta e Sahabëve

www.kmsh.al/botime

Ky botim në dy vëllime, vjen nga Komuniteti Mysliman jo vetëm si një përmbledhje fragmentesh nga jeta shembullore e sahabëve të të Dërguarit të Allahut (a.s.), por është edhe një histori e mirëfilltë e Islamit dhe pasqyrim i hollësishëm i jetës së Profetit tonë, pasi këtui, jeta e sahabëve, si dhe shumë nga ngjarjet që rrëfohen si të transmetuara nga burimet më të besueshme të Islamit, janë të paraqitura sipas një kategorizimi dhe prezantimi në kapituj të hartuar sipas kriterit tematik. Pra, dobia e prurjes së këtij libri në gjuhën shqipe, është se ai përmbush tri qëllime:

- 1 Një njohje më nga afër me përmasën e të qenët sahab i të Dërguarit të Allahut (a.s.), të cilën e garanton pasuria dhe larmia e historive të treguara në të.
- 2 Sjell në gjuhën shqipe një histori të Islamit në fillimet e tij, të parë si mënyrë jetese e pandarë nga jeta e përditshme.
- 3 Një dimension të posaçëm të përditshmërisë së jetës së të Dërguarit të Allahut (a.s.), të cilin një biografi e ka shumë të vështirë që ta paraqesë në tërësinë e tij, për shkak të pasurisë së informacionit.

BOTIM I RI

